



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 48/2019 regjistër (JR)
Datë 09.10.2019

Nr. 10 i vendimit
Datë 24.03.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian Hajdari	Kryesues
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 24.03.2021, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Arben Pasho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

OBJEKT: Shqyrtimi i vendimit nr. 147, datë 16.05.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni F, pika 2, Aneksi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 63, 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016"), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 147, datë 16.05.2019, ka vendosur *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Pasho, me funksionin prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.*
2. Komisioni zhvilloi procesin e rivlerësimit për të tria kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, dhe arriti në përfundimin se:

2.1 Konkluzione përfundimtare për vlerësimin e kriterit të pasurisë

Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, që rezultoi në disa pasaktësi në deklaram dhe një mosdeklarim të pjesës takuese në një pasuri të paluajjtshme, trupi gjykues, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, arrin në përfundimin se këto problematika nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm dhe nuk arrijnë deri në atë nivel që të përmbushin aplikimin e pikave 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në vlerësimin e tij, Komisioni mban parasysh edhe faktin se subjekti i rivlerësimit ka treguar gatishmërinë e tij të menjëhershme për të dhënë sqarime rreth fakteve të rezultuara nga hetimi, kur është pyetur nga Komisioni, po ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore duke krijuar bindjen se ai ishte i vërtetë në deklaramet e tij.

2.2 Konkluzione përfundimtare për vlerësimin e kriterit të figurës

*Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Pasho, ka plotësuar në mënyrë korrekte deklaramtën për kontrollin e figurës, pasi pavarësisht dijenisë së tij lidhur me procedimin penal nr. {***}, të vitit 2014, për veprën “Pastrim i produkteve të veprës penale”, formalisht, emri i shtetasit I. M., nuk figuron si person i regjistruar në regjistrin e veprave penale si autor i veprës penale dhe, për pasojë, ai nuk mund të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm në kuptim të pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar [...]”.*

Për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Pasho, Komisioni nuk pati asnjë të dhënë mbi veprimtarinë korruptive apo mbi kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në vlerësim të provave të administruara, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka cenuar asnjë nga parimet e parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, apo të pikave 2 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

2.3 Konkluzion përfundimtar për vlerësimin profesional

Nga vlerësimi i dokumenteve ligjore, kanë rezultuar disa mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit.

Në lidhje me situatën e konfliktit të interesit, konstatohet se të paktën në një rast subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

Nga vlerësimi tërësor i kriterit profesional, janë konstatuar mangësi dhe problematika, por trupi gjykues vlerëson se ato nuk janë deri në atë masë që të plotësojnë qëllimin e nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Komisioni, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, arrin në përfundimin se pavarësisht se nuk u vlerësua që problematikat e konstatuara për secilin komponent përbëjnë më vete shkak për shkarkim nga detyra, duke u analizuar në tërësinë e tyre, në vlerësim të Komisionit, konsiderohet se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

Në përfundim, mbështetur në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni bëri vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit Arben Pasho, në vlerësim të të tria kritereve, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

4. Komisioni, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në bazë të pikës 2 të nenit 4, të germës “c” të pikës 1 të nenit 58, të pikës 2 të nenit 59 dhe të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me vendimin nr. 147, datë 16.05.2019, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Pasho, me funksionin prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

II. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 147, datë 16.05.2019, të Komisionit është ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) nga subjekti i rivlerësimit Arben Pasho, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmim në detyrë. Shkaqet e ankimit konsistojnë kryesisht me arsyetimin e bërë nga Komisioni lidhur me tri denoncimet nga publiku ndaj subjektit të rivlerësimit, si dhe rastet e procedimeve penale ndaj shtetasit I. M., që lidhen dhe me situatën e konfliktit të interesit që, sipas subjektit, nuk përbëjnë cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
6. Subjekti pretendon në ankim, se në kushtet kur neni 3 i ligjit nr. 84/2016, nuk jep përkufizim për termin “cenim i besimit të publikut te drejtësia”, Komisioni duhet të sqaronte në mënyrë të qartë këtë term, si dhe saktësisht me çfarë indikatorit matet besimi i publikut te drejtësia.
7. Sipas subjektit, Komisioni ka mospërputhje të arsyetimit, se përderisa për secilin komponent të vlerësimit nuk u vlerësua se përbën shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, atëherë dhe tërësia e tyre, e cila përbëhet nga po këta komponentë, është e pamundur që të shërbejë si shkak për shkarkimin nga detyra.
8. Marrja e një mase disiplinore si shkarkimi nga detyra, në kushtet siç i ka parashtruar Komisioni në vendim, sipas subjektit, tregojnë se ky vendim vjen në kundërshtim me parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, ku në thelb të tyre qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave dhe vlerësimi objektiv i tyre. Komisioni ka shkelur parimin e proporcionalitetit, pasi masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk është në proporcion me rëndësinë e shkeljeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

III. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

9. Çështja e rivlerësimit me nr. 48/2019 regjistër (JR), datë 09.10.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Pasho, u mor në shqyrtim në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”). Subjekti i rivlerësimit, përpara shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, nuk paraqiti parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, si parashikuar në nenin 49, pika 2, fjalia e tretë e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.
10. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi çështjen në tërësi, shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe provat e administruara në këtë çështje, vlerëson si vijon.
Lidhur me pretendimin e subjektit *se Komisioni ka mospërputhje të arsyetimit, përderisa për secilin komponent të vlerësimit nuk u vlerësua se përbën shkak për shkarkimin nga detyra të*

subjektit të rivlerësimit, atëherë dhe tërësia e tyre e cila përbëhet nga po këta komponentë është e pamundur që të shërbejë si shkak për shkarkimin nga detyra, trupi gjykues konstaton se në dy nga kriteret e vlerësimit, konkretisht vlerësimin e pasurisë dhe aftësive profesionale, Komisioni ka arritur në konkluzionin se, për pasurinë, *problematikat e konstatuara nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm dhe nuk arrijnë deri në atë nivel që të përmbushin aplikimin e pikave 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, dhe për vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni ka vlerësuar se *nga vlerësimi tërësor i kriterit profesional, janë konstatuar mangësi dhe problematika, por trupi gjykues vlerëson se ato nuk janë deri në atë masë që të plotësojnë qëllimin e nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*. Sa më sipër, rezulton që Komisioni nuk ka gjetur të mjaftueshme problematikat për secilin nga dy kriteret, për të aplikuar një nga parashikimet e nenit 61, pikat 3 dhe 4, por në tërësinë e vlerësimit të fakteve të konstatuara të cilat do të trajtohen në vijim në këtë vendim, me të drejtë ka zbatuar nenin 61, pikën 5 të ligjit nr. 84/2016. Përkundër pretendimeve të subjektit, trupi gjykues çmon se është plotësisht e përshtatshme që institucionet e rivlerësimit të japin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi vetë ligji nr. 84/2016, në nenin 61, pika 5 e tij, autorizon në mënyrë specifike një masë të tillë disiplinore në rastet kur subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, si rasti objekt shqyrtimi. Përpos sa më sipër, edhe pse logjikisht veprimet e subjektit për secilin nga kriteret e rivlerësimit më vete mund të konsiderohen të pamjaftueshme për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit, institucionet e rivlerësimit, duke vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe objektive tërësinë e sjelljeve të subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtjen e interesit publik në këtë proces, legjitimohen në aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra, kur konkludojnë në cenimin e besimit të publikut sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

11. Sa i përket pretendimit të subjektit se *si matet cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*, trupi gjykues vlerëson se institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të gjenerojnë besim të vazhdueshëm te publiku, duke vepruar në mënyrë efektive dhe të drejtë, në përputhje me legjislacionin dhe duke e demonstruar këtë te qytetarët. Ka një sërë sjelljesh nëpërmjet të cilave subjektet e rivlerësimit minojnë integritetin e institucioneve të drejtësisë dhe cenojnë besimin e publikut në sistemin tonë të drejtësisë, përmes korrupsionit, marrëdhënieve të rreme, shkeljes së betimit si nëpunës publik, veprimet në situatën e konfliktit të interesit, paaftësisë në punën profesionale, vendosjes së interesave privatë përpara interesit publik etj. Për të identifikuar dhe vlerësuar problematikat e konstatuara nga Komisioni në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe aftësive profesionale të cilat kanë çuar Komisionin në zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues analizon në vijim të këtij vendimi dy komponentët e rivlerësimit, të aftësive profesionale dhe të pasurisë.

A. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe shkaqet e ankimit lidhur me këtë kriter

12. Trupi gjykues në Kolegj – referuar vendimmarrjes së Komisionit, i cili pasi ka kryer vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit Arben Pasho, në vlerësimin e të tria kriterëve, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë – vendosi që në fillim të shqyrtojë shkaqet e ankimit mbi vlerësimin e aftësive profesionale, lidhur me denoncimet e trajtuara në Komision dhe situatën e konfliktit të interesit, që kanë shërbyer si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues përgjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi vendosi të evidentojë se në cilat raste subjekti i rivlerësimit Arben Pasho me veprimet apo mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

13. Komisioni, lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzionin se, *nga vlerësimi i dokumenteve ligjore, kanë rezultuar disa mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit. Në lidhje me situatën e konfliktit të interesit, konstatohet se të paktën në një rast, subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Nga vlerësimi tërësor i kriterit profesional, janë konstatuar mangësi dhe problematika, por trupi gjykues vlerëson se ato nuk janë deri në atë masë që të plotësojnë qëllimin e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, apo pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*
14. Nga analizimi i vendimit të Komisionit, si dhe shkaqeve të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se konkluzioni mbi këtë kriter vlerësimi është mbështetur kryesisht në gjetjet e dy denoncimeve nga publiku, të shtetasit A. S. dhe L. P., si dhe mbi dosjet e procedimeve penale ndaj shtetasit I. M., të kërkuara për vlerësim lidhur me situatën e konfliktit të interesit. Ndërsa, për sa i përket denoncimit të shtetasit K. Ll., trupi gjykues konstaton se Komisioni edhe pse hetoi mbi këtë denoncim duke administruar dosjen e procedimit penal, në vendimin përfundimtar nuk doli me një konkluzion konkret, por vetëm me konstatimin se *çështja vijon ende të jetë nën hetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyrokastër.* Trupi gjykues i Kolegjit mori në analizë aktet e dosjeve të procedimeve penale dhe gjyqësore që lidhen pikërisht me dy denoncimet nga publiku, si dhe ato në ngarkim të z. I. M., për të cilat janë konstatuar problematika dhe vlerëson si më poshtë.
15. Në Komision është administruar me nr. {***} prot., datë 08.02.2018, denoncimi i shtetasit A. S., adresuar disa subjekteve të rivlerësimit: M. I., J. Ç., I. S. dhe Arben Pasho. Sipas denoncuesit, prokurorët Arben Pasho dhe J. Ç. *janë bërë palë me paditësit dhe të gjitha vendimet që kanë dhënë bien në kundërshtim me veten. Vonesa pafund. Prokurorët mbrojnë falsifikimin, mohojnë të gjitha aktet ku falsifikimet janë të qarta duke thënë se s’ka ndërhyrje. Nuk marrin parasysh përdorimin e dokumentit të falsifikuar, zvarrisin çështjet hetimore nga një deri në katër vjet.* Denoncuesi pretendon se subjektet kanë kryer shpërdorim detyre dhe korrupsion.
16. Në lidhje me këtë denoncim, Komisioni, në vendim, *pas analizimit të dokumentacionit në dosje dhe shpjegimeve të subjektit, konkludon se veprimet e subjektit të rivlerësimit në nxjerrjen e dy vendimeve, konkretisht vendimi i pushimit të procedimit penal nr. {***}/2011, datë 2.12.2011 dhe vendimi që shfuqizon vendimin e mësipërm të pushimit të prokurorit, janë marrë pa kryer një analizë të thelluar profesionale që do të justifikonte këtë vendimmarrje, dhe në mënyrë impulsive, çka nuk përkon me etikën e tij si prokuror.* Zëvendësimi i prokurorëve në këtë procedim penal është bërë në mënyrë verbale dhe i pamaterializuar me një dokument ligjor, sipas përcaktimeve të nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale, çka nuk garanton të drejtat e palëve.
17. Nga analizimi i akteve në dosjen e procedimit penal të administruar nga Komisioni, trupi gjykues konstaton si më poshtë vijon.
- Më datë 03.08.2011, pranë Sektorit kundër Krimin Financiar është paraqitur dhe ka bërë kallëzim penal shtetasi A. S. në ngarkim të shtetasve Sh. H. dhe V. H.
 - Mbi bazën e këtij kallëzimi penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër ka regjistruar në datën 04.08.2011, procedimin penal nr. {***} për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.
 - Më datë 02.12.2011, me vendimin “Mbi pushimin e procedimit penal”, prokurori i çështjes S. Ç. vlerëson se nuk kemi të bëjmë me elemente të veprës penale të falsifikimit të aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. {***}, të konsumuar nga shtetasit e kallëzuar. Sipas prokurorit, kemi të bëjmë me një çështje civile, e cila mund të zgjidhet nga palët

nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së tyre në gjykatë nëpërmjet një padie civile. Me shkresën nr. {***} prot., datë 12.12.2011, kallëzuesi A. S. njoftohet për vendimin e pushimit të procedimit penal të prokurorit.

- Më datë 13.12.2011, nga drejtuesi i prokurorisë Arben Pasho, është marrë vendimi “Mbi shfuqizimin e vendimit “Për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}-2011”, datë 02.12.2011 të prokurorit S. Ç.”, duke e vlerësuar vendimin e pushimit si të pabazuar në prova dhe në ligj, duke çmuar se veprimet hetimore nuk janë të plota dhe në këto rrethana konkluzioni i arritur në përfundim të hetimeve çmohet se është i gabuar, duke urdhëruar rifillimin e hetimit dhe kryerjen e veprimeve të tjera hetimore.
- Me vendimin “Mbi pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***} të vitit 2011” të datës 17.01.2013, prokurori i çështjes S. Ç. përsëri vendos pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2011.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 02.04.2013, në çështjen me objekt *kundërshtimin e vendimit e pushimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2011 dhe {***} të vitit 2012 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë*, vendosi pranimin e kërkesës së kërkuarit A. S., prishjen e vendimit të pushimit të hetimeve të datës 17.01.2013 që i përket procedimit penal nr. {***} të vitit 2012 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve. Ky vendim mori formë të prerë pasi nuk u ankimua.
- Më datë 07.09.2015, me vendimin “Për pushimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2011”, prokurori i çështjes J. Ç. vendosi të *pushojë hetimet e çështjes penale në kushtet e nenit 328/1/d të Kodit të Procedurës Penale (ekziston një shkak që e shuan veprën penale, ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë)*.
- Me vendimin nr. {***}, datë 04.03.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në çështjen me kërkuar A. S., palë e interesuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, përfaqësuar nga prokurori J. Ç., si dhe shtetasit Sh. H. e V. H., me objekt “Kundërshtimin e vendimit *Për pushimin e procedimit penal*”, datë 07.09.2015, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, vendosi pranimin e kërkesës së kërkuarit A. S., prishjen e vendimit të pushimit të çështjes penale nr. {***} të vitit 2011, datë 27.09.2015, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke urdhëruar vazhdimin e veprimeve hetimore. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 12.05.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 04.03.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
- Prokurori i çështjes J. Ç., me vendimin e datës 19.07.2017, “Mbi pushimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2011”, vendosi të pushojë hetimet e çështjes penale nr. {***} të vitit 2011, në kushtet e nenit 328/1/dh të Kodit të Procedurës Penale (*fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale*). Më datë 06.09.2017, është bërë njoftimi i vendimit të pushimit nga drejtuesi i prokurorisë Arben Pasho.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, pas kërkesës së shtetasit A. S., *për prishjen e vendimit të pushimit të çështjes dhe detyrimin e prokurorisë të rifillojë hetimet për kallëzimin e paraqitur nga ankuesi*, me vendimin nr. {***}, datë 31.10.2017, vendosi rrëzimin e kërkesës së A. S. për kundërshtimin e vendimit të pushimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Me vendimin nr. {***}, datë 25.01.2018, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. {***}, datë 31.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

18. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e Komisionit *se vendimi i pushimit të procedimit penal nr. {***}, datë 2.12.2011 dhe vendimi që shfuqizon vendimin e pushimit të prokurorit janë marrë pa kryer një analizë të thelluar profesionale që do të justifikonte këtë vendimmarrje, dhe në mënyrë impulsive, çka nuk përkon me etikën e tij si prokuror, pasi, sipas tij, këto konkluzione nuk u përgjigjen fakteve, ligjeve dhe së vërtetës.*
19. Lidhur me marrjen e dy vendimeve nga subjekti i rivlerësimit si drejtues i prokurorisë, përkatësisht njoftimin e vendimit të pushimit të procedimit penal të prokurorit S. Ç. më datë 12.12.2011 dhe një ditë më pas, më 13.12.2011, shfuqizimin e këtij vendimi si të pabazuar në prova dhe në ligj, duke i konsideruar jo të plota veprimet hetimore, trupi gjykues, edhe pse vlerëson se subjekti mund të kishte shfuqizuar vendimin e pushimit përpara se t'ia njoftonte kallëzuesit A. S. dhe t'i kërkonte prokurorit të çështjes vazhdimin e hetimeve, përsëri çmon se, bazuar në parashikimet e nenit 24, pika 5 e Kodit të Procedurës Penale, para ndryshimeve të tij me ligjin nr. 35/2017, *prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët me ankim ose kryesisht.* Për këtë arsye, trupi gjykues nuk e vlerëson shkelje ligjore shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***}, datë 2.12.2011, të marrë nga subjekti i rivlerësimit, si drejtues i prokurorisë, pasi ky vendim i pushimit i ishte njoftuar palës kallëzuese.
20. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se prokurori i çështjes për procedimin penal nr. {***} të vitit 2011 ka qenë prokuror S. Ç. dhe më pas çështja i ka kaluar prokurorit J. Ç. Lidhur me zëvendësimin e prokurorit, subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ deklaroi se *pas shfuqizimit të vendimit të pushimit të çështjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë më datë 02.04.2013, pas ankimit të shtetasit A. S., duke marrë parasysh faktin që A. S. kishte kontestuar veprimtarinë e prokurorit S. Ç., si dhe me qëllim mosparagjykimin e zgjidhjes që do të rezultonte për çështjen, është vendosur zëvendësimi i prokurorit me prokuror J. Ç., i cili do ta zgjidhte drejt e në kohë të arsyeshme çështjen. Vendimi im u është komunikuar të dy prokurorëve. Mungesa e aktit të zëvendësimit të prokurorit nuk ka sjellë asnjë pasojë në çështjen penale dhe prokurori S. Ç. ka dhënë pëlqimin verbal për zëvendësimin.*
21. Në kuptim të nenit 27, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale mbi rastet e zëvendësimit të prokurorit, *drejtuesi i prokurorisë vendos zëvendësimin e prokurorit kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën, si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17, paragrafi i parë shkronjat "a", "b", "ç", "d" dhe "dh". Në rastet e tjera, prokurori zëvendësohet vetëm me pëlqimin e tij.* Në rastin objekti shqyrtimi, së pari nuk rezulton që prokurori i zëvendësuar të ndodhet në një nga rastet e parashikuara në këtë dispozitë që do të çonin në zëvendësimin e tij; së dyti, në dosjen e procedimit penal nuk rezulton të jetë dokumentuar pëlqimi i prokurorit për zëvendësimin, si dhe nuk është administruar urdhër për zëvendësimin e kryer nga drejtuesi i prokurorisë. Sa më sipër, pretendimi i subjektit se vendimi i zëvendësimit u është komunikuar të dy prokurorëve dhe mungesa e aktit nuk ka sjellë asnjë pasojë në çështjen penale dhe se prokurori S. Ç. ka dhënë pëlqimin verbal, nuk rezulton i provuar. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se zëvendësimi i prokurorit të çështjes është kryer në kundërshtim me nenin 27, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale.
- Në përfundim, për denoncimin e shtetasit A. S., trupi gjykues evidentoi shkelje ligjore lidhur me zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale.**
22. *Lidhur me denoncimin e administruar në Komision, nr. {***} prot., datë 15.03.2019, nga shtetasja L. P., e cila ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit Arben Pasho mbi vlerësimin profesional, për pushimin e çështjes së saj padrejtësisht, duke mos studiuar dosjen, prokurori, sipas pretendimeve të denoncueses, ka vendosur pushimin e çështjes penale. Ndërkohë, sipas*

fletëthirrjes së gjykatës, çështja ishte dërguar për gjykim dhe prokurori para gjykatës ka deklaruar se është bërë gabim nga kancelarja, gjë që sipas denoncueses nuk është e vërtetë sepse në takimin e fundit me prokurorin, i është thënë prej tij “merr avokat për t’u përfaqësuar në gjykatë”. Çështja u pushua në gjykatë dhe prokurori, sipas denoncueses, për t’i ardhur në ndihmë personit të kallëzuar, ishte shprehur që denoncuesja duhet të hapte një proces gjyqësor për të kërkuar servitut kalimi, ndërkohë që sipas saj të gjitha dokumentet vërtetonin se ajo pjesë ishte e zgjidhur.

23. Komisioni, në vendim lidhur me këtë denoncim, *referuar dokumentacionit në dosjen penale, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, konstaton se dosja ka disa mangësi procedurale, për të cilat subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdes duke kryer verifikimet përkatëse, pavarësisht shpjegimeve të tij se ato i referohen neglizhencës së sekretarisë së prokurorisë.*

Subjekti, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, nuk rezultoi të ketë ndërmarrë ndonjë veprim parandalues apo masë disiplinore në ngarkim të punonjësve të sekretarisë së prokurorisë për shkelje të ndryshme administrativo-ligjore (njoftimi i vendimit palëve me vonesë, përcjellja gabimisht e dosjes në gjykatë etj.).

24. Nga analizimi i akteve të dosjes së procedimit penal të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit Arben Pasho, trupi gjykues konstaton si më poshtë vijon.

- Më datë 11.12.2017, është paraqitur dhe ka bërë kallëzim penal shtetasja L. P. ndaj shtetasit H. K., për veprën penale “Vetëgjyqësi”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.
- Më datë 12.12.2017, Oficeri i Policisë Gjyqësore, me “Informacion për referimin e veprës penale te prokurori”, i kalon materialet procedurale Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër në ngarkim të shtetasit H. K. për kundërvajtjen penale “Vetëgjyqësi” e “Mosbindje ndaj urdhrin të punonjësit të policisë së rendit publik, parashikuar nga nenet 227 e 242 të Kodit Penal.
- Me urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal, datë 12.12.2017, është urdhëruar të bëhet regjistrimi i çështjes penale për veprën penale “Vetëgjyqësi”, vepër e parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.
- Me urdhrin e datës 26.12.2017 të prokurorit, urdhërohet kryerja e veprimeve hetimore nga Oficeri i Policisë Gjyqësore brenda datës 30.01.2018 dhe në përfundim të relatohet me shkrim te prokurori i çështjes.
- Më datë 27.02.2018, Oficeri i Policisë Gjyqësore Y. Z., në relacionin “Mbi përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2017 për veprën penale “vetëgjyqësi”, të parashikuar nga neni 277 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit H. K., sugjeron dërgimin për gjykim të procedimit penal.
- Pas një sërë hetimesh të tjera të kryera, më datë 27.06.2018, Oficeri i Policisë Gjyqësore Y. Z. harton relacionin “Mbi përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2017”, sipas të cilit çështja penale duhet të pushohet pasi konflikti është civil dhe duhet të zgjidhet me padi civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, duke sugjeruar pushimin e hetimeve të procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit H. K.
- Me vendimin e datës 15.07.2018, prokurori i çështjes, subjekti i rivlerësimit Arben Pasho, vendosi: *Pushimin e çështjes penale nr. {***}-2017, në ngarkim të shtetasit H. K., për arsye se fakti i konstatuar nuk përbën vepër penale. Me këtë vendim të njihen të*

interesuarit të cilët, në referim të nenit 329, kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Shkallës së Parë Gjirokastrë.

- Me datë 07.01.2019, me shkresën nr. {***} prot., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë i njofton kallëzueses L. P., një kopje të vendimit të pushimit të hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017.
 - Me shkresën nr. {***} prot., po në datë 07.01.2019, Prokuroria dërgon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2018, për shkak se faktet e kallëzuara nuk parashikohen nga ligji si vepër penale. Kjo çështje regjistrohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë më 10.01.2019.
 - Me vendimin për caktimin e seancës paraprake të çështjes penale, gjyqtarja vendosi të caktojë datën 17.01.2019, për të cilën njofton të hetuarin, kallëzuesen dhe prokurorin. Kallëzueses i dërgohet fletëthirrja për t'u paraqitur e dëgjuar si kallëzuese në çështjen penale kundër shtetasit H. K., *për pushim procedimi penal.*
 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në vendimin nr. {***}, datë 25.02.2019, çmon se veprimet hetimore janë të plota dhe prokurori i çështjes me të drejtë ka vendosur: *pushimin e çështjes penale nr. {***}-2017 në ngarkim të shtetasit H. K., për arsye se fakti i konstatuar nuk përbën vepër penale.* Ky vendim i prokurorit nuk kërkon miratim në gjykatë. Nëse palët kanë kundërshtime për vendimin e prokurorit, kanë të drejtën e kundërshtimit në gjykatë pas marrjes së njoftimit, pasi kjo vepër parashikohet në ligj si kundërvajtje penale. Prokurori sqaroi para gjykatës se nga sekretaria kjo kërkesë gabimisht është përcjellë në gjykatë, ndaj kërkoi pushimin e shqyrtimit të kësaj kërkesë.
25. Nga aktet e fashikullit të prokurorisë, rezulton se regjistrimi i procedimit penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë mban datën 12.12.2017, vendimi për pushimin e këtij procedimi penal është i datës 15.07.2018, pra duke tejkaluar afatin prej 3 muajsh për përfundimin e hetimeve të parashikuara në nenin 323, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, pa marrë vendim për zgjatje afati hetimor.
26. Në kuptim të parashikimeve të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale:
1. *Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: [...]*
 - b) *fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.[...].*
 2. *Prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, duke u bërë të ditur të drejtën për t'u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë.*
27. Në procedimin penal objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se vendimi i pushimit të procedimit nga prokurori i çështjes Arben Pasho është marrë më datë 15.07.2018 dhe i është njoftuar kallëzueses më datë 07.01.2019, pra rreth gjashtë muaj më vonë, gjë që e bën të pabazuar pretendimin e subjektit se *ankesa e shtetases nuk ka asnjë bazë ligjore dhe faktike pasi vendimi i pushimit të çështjes penale nga subjekti i rivlerësimit për kundërvajtjen penale të "Vetëgjyqësisë" është i drejtë.* Trupi gjykues arsyeton se edhe në rastet kur vendimi i prokurorit për pushimin e procedimit penal vlerësohet i drejtë nga gjykata dhe lihet në fuqi, përsëri *afati i arsyeshem* është një element kryesor në zgjidhjen e çështjes pasi, përderisa ka një konflikt, dhënia e drejtësisë në një afat të arsyeshem forcon sigurinë juridike dhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

28. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se mosmarrja nga ana e tij e ndonjë veprimi parandalues apo mase disiplinore në ngarkim të punonjësve të sekretarisë së prokurorisë për kalimin gabimisht të dosjes penale në gjykatë, të cilat Komisioni i konsideron si mangësi procedurale të dosjes, nuk janë të asaj shkalle që të përbëjnë cenim të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Sa i përket këtij pretendimi, në vijim dhe të arsyetimit më sipër, trupi gjykues vlerëson se edhe nëse një shkelje ligjore e vetme mund të mos jetë në atë shkallë që të cenojë besimin e publikut te drejtësia, në rastin konkret konstatohen disa shkelje ligjore radhazi, të cilat së bashku përbëjnë shkak për cenim të besimit. Për rastin në fjalë, konstatohen disa cedime nga ana e tij si drejtues. Së pari, subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar afatin 5-ditor për njoftimin e vendimit të pushimit të procedimit penal, por personi që ka bërë kallëzimin njoftohet pas 6 muajsh, një kohë relativisht e gjatë. Më tej, sipas subjektit, gabimisht sekretaria e ka përcjellë dosjen në gjykatë, ndërkohë që sipas pikës 2 të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, në rastin e vendimit të pushimit të çështjes për kundërvajtje penale, gjykata mund të investohet nëpërmjet ankimit të ushtruar nga i pandehuri, mbrojtësi i tij ose nga kallëzuesi, në rastin konkret nga denoncuesja, së cilës duhej t'i bëhej e ditur e drejta për t'u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë sipas përcaktimit të nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale.

Për denoncimin e shtetasës L. P., trupi gjykues evidenton shkelje ligjore me mosmarrjen e masave organizative për njoftimin e vendimit të pushimit të çështjes penale brenda afatit ligjor, siç është parashikuar në nenin 328, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, për të ushtruar më pas të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimit të pushimit të çështjes sipas nenit 329, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale brenda afatit ligjor.

Lidhur me procedimet penale në ngarkim të z. I. M.

29. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndër të tjera se:

*Kam pasur detyrim financiar afatshkurtër ndaj shtetasit I. T. M. në shumën 14.000 (katërbëdhjetë mijë) euro, i pamaterializuar me deklaratë noteriale. Shuma e mësipërme, për arsye objektive, është paguar nga llogaria e shtetasit të mësipërm në dt. 23 gusht 2016 në nr. e llogarisë {***} të Universitetit të {***} Holandë për tim bir, studentin O. A. P., i cili ka filluar studimet për master njëvjeçar në shtator 2016 në këtë universitet, pasi në atë moment nuk e disponoja këtë shumë.*

*Për shlyerjen e detyrimit të mësipërm kam marrë Kredi Bankare Afatshkurtër ose kredi ekspres 1-2 vjet nr. {***} dt 03.11.2016 pranë “Banka Societe Generale Albania”, dega Gjirokastër në shumën 1.000.000 (një milion) lekë. E konvertuar me kursin e këmbimit valutor dt. 22.11.2016, shuma e mësipërme shkon në vlerën 7 070 euro, shumë e cila është transferuar nga banka kredihënëse tek llogaria e shtetasit I. T. M.*

*Për shlyerjen e pjesës së mbetur të detyrimit ndaj shtetasit I. T. M. në dt. 30.12.2016 janë kryer veprime financiare pranë BKT Dega Gjirokastër. Nga depozita e kursimit të b/shortes M. P. pranë BKT, është tërhequr shuma 240.028,21 lekë (kursime të deklaruara ndër vite – nga viti 2008) dhe pasi janë shtuar 700.000 lekë kursime që i përkasin vitit 2016, nga të cilat 560 mijë janë kursime nga pagat e vitit 2016 dhe 140.000 lekë nga qiraja e banesës në lagjen {***}, është konvertuar në euro me kursin ditor në këtë bankë dhe janë kaluar në llogarinë e z. I. M. shuma 7 030 euro. Aktualisht detyrimi i mbetur ndaj Bankës Societe [...] 930.972,72 lekë.*

30. Lidhur me detyrimin financiar ndaj shtetasit I. M., për shumën 14.000 euro të pamaterializuar në dokument ligjor dhe të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, që e bën I. M. person tjetër të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016,

Komisioni ka kërkuar informacion në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Gjirokastër, bankat e nivelit të dytë dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

31. Për të përcaktuar marrëdhënien e subjektit Arben Pasho me shtetasin I. M., Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 25.03.2019, i drejtohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për vënien në dispozicion të kërkesave për gjykim, vendime mosfillimi apo pushimi në lidhje me subjektet: 1) shtetasin I. T. M.; 2) shoqërinë {***} ShPK; 3) shoqërinë “{***}” ShPK; 4) shoqërinë “{***}” ShPK, shoqëri tregtare në të cilat, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 31.12.2018, të Qendrës Kombëtare të Biznesit, z. I. M. ka cilësinë e administratorit/ortakut.
32. Nga dosjet e procedimeve penale të përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.03.2019, rezulton se në dy procedime penale, përkatësisht nr. {***} të vitit 2014 dhe nr. {***} të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, pra të prokurorit më të lartë në kuptim të nenit 3/b, pika 2 e ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionim e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe prokuror i çështjes në dosjen e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, si vijojnë.
33. Komisioni në konkluzion, *pasi analizoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucionet, shpjegimet e subjektit dhe të shtetasit I. M., si dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasin I. M. kanë pasur njohje të hershme dhe lidhje miqësore dhe interesi.*
Pavarësisht këtij fakti, subjekti ka hetuar në një rast drejtpërdrejt kallëzimin penal ndaj shtetasit I. M. (në vitin 2015) dhe në dy raste të tjera (vitet 2014 dhe 2015) në cilësinë e drejtuesit të institucionit, dhe ai nuk ka ndërmarrë asnjë nga veprimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndodhjen në situatë të mundshme apo faktike të konfliktit të interesit. Nga vlerësimi i materialeve në dosje, por edhe nga shpjegimet e subjektit në rezultatet e hetimit dhe në seancë dëgjimore, nuk është vërejtur ndonjë rrethanë që favorizon drejtpërdrejt shtetasin I. M. dhe nuk është provuar ndonjë ndikim i mundshëm i subjektit të rivlerësimit në këto procedime penale, pavarësisht këtij fakti në vijim të logjikës, Komisioni vlerëson se marrëdhënia mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit I. M., dhe veçanërisht ajo e huasë në vitin 2016, në tërësinë e saj, nuk është një marrëdhënie korrekte, pasi ajo vë në dyshim veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe cenon besimin e publikut të sistemit të drejtësisë.
34. Nga analizimi i akteve të procedimeve penale në ngarkim të shtetasit I. M., trupi gjykues konstaton si më poshtë vijon.

Lidhur me procedimin penal nr. {}, viti 2014***

- Nga Sektori për Krimin Ekonomik dhe Financiar, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokastër, me shkresën nr. {***}, datë 26.05.2014, janë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër materialet procedurale për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.
- Për procedimin penal nr. {***} të vitit 2014, më datë 30.12.2014, prokurori i çështjes P. D., për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, vendosi të pushojë hetimet e çështjes penale për arsye se faktet e relatuar dhe të hetuara nuk përbëjnë vepër penale, si dhe heqjen e sekuestros mbi llogaritë bankare pranë Raiffeissen Bank, euro dhe dollarë amerikanë, të shtetasve I. M. dhe A. H.

- Më datë 20.03.2015, vendimi i pushimit të hetimeve në lidhje me procedimin nr. {***} të vitit 2014 i njoftohet Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. {***} prot. të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë. Nga aktet e administruara në dosje, nuk rezulton që vendimi i prokurorit për pushimin e procedimit penal të jetë ankimuar në gjykatë.

Lidhur me procedimin penal nr. {}, viti 2015***

35. Më datë 25.05.2015, prokurori i çështjes Gj. F. vendosi mosfillimin e procedimit penal lidhur me materialin kallëzues të referuar nga Komisariati i Policisë Gjirokastrë, me shkresën nr. {***} prot., datë 17.04.2015. Në këtë vendim, prokurori arsyeton se objekti ku po kryheshin punime është në pronësi të shoqërisë {***} ShPK, me administrator I. M., kështu që provohet fakti se objekti ishte në gjendje të përfunduar dhe po kryheshin vetëm punime të brendshme, për këtë arsye mungon objekti i veprës penal të “Ndërtimit të paligjshëm”, të parashikuar në nenin 199/a të Kodit Penal.

Lidhur me procedimin penal nr. {}, viti 2015***

- Më datë 17.08.2015, Oficeri i Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, i referon prokurorit ngjarjen e ndodhur në vendin e quajtur kthesa e fshatit {***} në shtratin e lumit Drino, në Dropullin e Poshtëm, ku nga kontrolli i Sektorit të Krimit Ekonomik në Drejtorinë e Policisë Qarku Gjirokastrë, është kapur në shtratin e këtij lumi një skrep dhe dy kamionë të ngarkuar me zhavorr lumi, që ecnin në drejtim të pikës së grumbullimit të inerteve të shoqërisë “{***}” ShPK.
 - Me shkresën nr. {***} prot., datë 19.08.2015, Drejtoria e Policisë e Qarkut Gjirokastrë dërgon në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë materialet procedurale të kundërvajtjes penale “Shpërdorimi i tokës”, parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal, në ngarkim të administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, shtetasit I. M.
 - Më datë 24.08.2015, prokurori i çështjes Arben Pasho, pasi administroi materialin kallëzues të dërguar nga Komisariati i Policisë Gjirokastrë, i cili është referuar pranë kësaj prokurorie në lidhje me një fakt penal, i cili në vlerësimin e oficerëve të policisë gjyqësore konfiguror veprën penale “Shpërdorim i tokës”, vepër penale e parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal, vendosi: *Mosfillimin e procedimit penal në lidhje me materialin kallëzues nr. {***} prot., datë 19.08.2015, pasi fakti i konstatuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.*
 - Më datë 25.08.2015, prokurori i çështjes Arben Pasho vendos kryerjen e ekspertimit tekniko-topografik, duke i ngritur ekspertit K. M., dy pyetje: i) *Vendi ku mjeti Varisk ka punuar për ngarkim me material inert, a ndodhet brenda zonës së shfrytëzimit të përcaktuar në lejen nr. {***}, datë 21.05.2010, për subjektin “{***}” ShPK? ii) Sa është volumi i materialit inert të marrë në zonën e miratuar në lejen përkatëse për subjektin “{***}”?*
 - Më datë 26.08.2015, eksperti ing. K. M. përpilon aktin e ekspertimit teknik, duke konstatuar se vendi ku mjeti i ngarkimit Warinsk ka punuar është në koordinatat sipas lejes dhe nuk rezulton të jetë marrë më shumë se 55.000 m³ për një periudhë 3-vjeçare.
36. Referuar kronologjisë së veprimeve procedurale më sipër, rezulton se vendimi i prokurorit Arben Pasho (më datë 24.08.2015) për mosfillimin e procedimit penal ndaj shtetasit I. M., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, është marrë një ditë përpara marrjes së vendimit për kryerjen e ekspertimit tekniko-topografik (25.08.2015) dhe dy ditë përpara depozitimit të

aktit të ekspertimit të ekspertit K. M. (26.08.2015), të cilit subjekti i rivlerësimit i referohet në vendimin e mosfillimit të procedimit. Pra, rezulton se subjekti ka marrë vendimin e mosfillimit të procedimit penal, pa pritur rezultatet e aktit të ekspertimit.

37. Nga aktet e dosjes hetimore të përcjella në Komision nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, trupi gjykues konstaton se me vendimin nr. {***}, datë 31.01.2006, të Këshillit Rregullator të Territorit, është miratuar leja e ndërtimit për shoqërinë {***} ShPK, për objektin “Nyje fraksionimi dhe betonimi” {***}. Referuar lejes nr. {***}, datë 21.05.2010, të Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Vjosë (Këshilli Kombëtar i Ujit) “Për shfrytëzim materialesh inerte në shtratin e lumit”, subjektit {***} ShPK i është akorduar leja për shfrytëzimin e shtratit të lumit Drino, Baseni Ujëmbledhës Vjosë, Dropulli i Poshtëm. Sipërfaqja e shfrytëzimit (në 3 vjet) 0.057 km², volumi i materialit që do të merret në 3 vjet, 60.000 m³, ose 20 000 m³/vit. Kjo leje është e vlefshme deri më datë 21.05.2015 dhe koha e veprimit në shtratin e lumit është ajo e përcaktuar në vendimin nr. {***}, datë 21.06.2006, të KKU-së (1 qershor deri më 31 tetor). Në pikën 7 të kushteve të lejes së shfrytëzimit, parashikohet: *subjekti që disponon këtë leje duhet të paraqesë pas tri vitesh shfrytëzimi, projektin e shfrytëzimit dhe rehabilitimit për 2 vitet pasardhëse.* Referuar procesverbalit të inspektimit të datës 25.01.2015 të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave, administruar në dosje, rezulton se subjekti {***} ShPK ka paraqitur një relacion mbi punimet e kryera për rehabilitimin e shtratit të lumit ku nga kontrolli i kryer nga inspektorati, kishte rezultuar se relacioni përputhej me realizimin në terren. Në vazhdimësi, në këtë procesverbal lihej detyrë mirëmbajtja e terrenit përreth brigjeve.
38. Në lidhje me këtë fakt, në vendimin për mosfillimin e procedimit penal të marrë nga subjekti i rivlerësimit, citohet: *[...] çmohet se fakti i konstatuar nuk konfiguron elementet e figurës së veprës penale “Shpërdorimi i tokës”, parashikuar nga neni 199 i K.Penal pasi në rastin konkret toka nuk është shpërdoruar në kundërshtim me destinacionin e saj, përkundrazi ka një akt ligjor, leja nr. {***}, dt. 21.05.2010, i cili përcakton dhe rregullon regjimin juridik të kësaj sipërfaqeje toke. Njëkohësisht, duke qenë se në rastin konkret sasia e materialeve inerte të zhvendosura nga sipërfaqja e miratuar nuk ka kapërcyer volumin 60.000 m², fakti i ndodhur nuk konfiguron kundërvajtje administrative për të cilën duhet të aplikoheshin dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore.*
39. Duke marrë parasysh kushtet e lejes së shfrytëzimit dhe procesverbalet e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave për rehabilitimin e shtratit të lumit, trupi gjykues konstaton se shoqëria {***} ShPK, përfaqësuar nga administratori I. M., ka marrë materiale inerte në shtratin e lumit në një kohë kur leja e shfrytëzimit nuk ishte më e vlefshme dhe kur, sipas relacionit të kësaj shoqërie, ishte kryer dhe rehabilitimi i shtratit të lumit. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, si prokuror i çështjes, nuk duhet të kishte hetuar vetëm faktin nëse materialet inerte ishin marrë në vendin sipas koordinatave të lejes, apo sasisë së përcaktuar në të, por së pari mbi ligjshmërinë e veprimit, i cili rezulton të jetë kryer pa leje nga organet kompetente, pasi leja e kishte përfunduar afatin e vlefshmërisë. Përpos sa më sipër, fakti i mbylljes së veprimeve hetimore brenda një jave nga regjistrimi i kallëzimit penal, nxjerrja e vendimit të mosfillimit të procedimit penal një ditë përpara vendimit për kryerjen e ekspertimit, apo dy ditë përpara rezultateve të tij dhe më pas arsyetimi në vendimin e mosfillimit të procedimit penal të krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit si prokuror i çështjes ka favorizuar shtetasin I. M. në këtë procedim penal.
40. Pas analizimit të materialeve të ardhura nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë lidhur me procedimet penale më sipër, për t’u informuar mbi marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit Arben Pasho me shtetasin I. M., Komisioni i drejtohet këtij të fundit me *e-mail-in*

e datës 10.04.2019, ku i kërkon ndër të tjera dhe shpjegime për rrethanat e njohjes mes tyre. Në përgjigjen e datës 13.04.2019, dërguar Komisionit nëpërmjet adresës elektronike, shtetasi I. M. ka deklaruar se me subjektin e rivlerësimit Arben Pasho njihet që në vitin 1993 dhe kanë njohje 26-vjeçare, meqenëse janë dhe bashkëqytetarë. Ai deklaroi se me subjektin Arben Pasho ka një *marrëdhënie korrekte shoqërore, e bazuar në respekt reciprok që përgjatë viteve ka ardhur duke u forcuar.*

41. Në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ të Komisionit, subjekti i rivlerësimit shprehet se: *shtetasin I. M. e njoh prej vitit 1993, si bashkëqytetar i Gjirokastrës, por kam pasur marrëdhënie korrekte. Në asnjë rast deri në momentin që unë kam marrë huanë, të cilën e kam deklaruar, unë dhe familjarët e mi apo të bashkëshortes sime kurrë nuk kemi pasur as raporte juridike ose raporte të tilla interesi që do të më vinin në detyrimin për të mos hetuar apo për t'u përjashtuar nga vendimmarrja. [...] Në këto kushte, kur është filluar procedimi penal nr. {***} i vitit 2014 dhe kanë ardhur dy materialet e tjera me nr. {***}, datë 17.04.2015 dhe nr. {***}, datë 19.08.2015, kam qenë po në këto raporte dhe nuk kam pasur asnjë shkak njëanshmërie, si ato që përcaktohen në nenet 15, 16 dhe 17 të K.Penale. Nga momenti kur janë trajtuar ligjërish këto materiale deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre, raporti ka qenë korrekt dhe nuk kam pasur shkaqe njëanshmërie. [...] Në lidhje me sa shprehet z. I. M., se marrëdhënia ka ardhur duke u forcuar, unë pranoj dhe pohoj se e vlerësoj si person pa probleme me ligjin dhe si biznesmen dhe person që nuk është marrë me aktivitete të tjera [...].*
42. Në përgjigje të pyetjes nr. 9 të pyetësorit standard të Komisionit, lidhur me udhëtimet e kryera jashtë Shqipërisë në shtatë vitet e fundit, përfshirë edhe pushimet, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka udhëtuar *dy herë me automjetin Benz "{***}" me drejtues dhe pronar z. I. M., biznesmen [...] Kam bërë një udhëtim në Selanik, ku kam fjetur një natë te hotel "{***}", i ftuar nga shtetasi I. M., me automjetin "{***}"*. Qëllimi i vizitës së shtetasit I. M. ka qenë riparimi i një makinerie ndërtimi, presë për ngjitjen e betonit në lartësi. O. P.: - *ka kryer udhëtim me destinacion qytetin e Marsejës, Francë, datë 11.06.2016 deri në datën 18.06.2017, me ftesë të shtetasit I. M., i cili ndërkohë ka qenë drejtues dhe pronar i automjetit Benz me targë "{***}"*. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë turistik.
43. Në dritën e fakteve që procedimet penale i janë mbyllur dhe vijimësia e marrëdhënies tregon një miqësi shumë të ngushtë, subjekti i rivlerësimit duhet që minimalisht të kishte dhënë dorëheqjen nga çështjet në ngarkim të këtij biznesmeni. Në këtë konsideratë, vlen përcaktimi nga neni 6, pika 2 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar dhe Parimet e Bangalores [Vlera nr. 2, paragrafi 2.3]. Duke lexuar të dyja këto përcaktime, rezulton që magjistrati duhet të silltet në një mënyrë që i jep përparësi detyrës, duke minimizuar rastet në të cilat do të jetë e nevojshme të përjashtohet nga vendimmarrja. Në këtë kuadër, edhe shoqëritë apo miqësitë e magjistratëve duhet të shihen në thjerrat se sa preket ushtrimi i detyrës nga miqësitë që njerëzit zgjedhin të ruajnë. Subjekti i rivlerësimit ka dështuar ta bëjë këtë analizë, gjykuar nga gjithë rrethanat faktike të shtjelluara në këtë arsyetim.
44. Trupi gjykues vlerëson se faktet më sipër provojnë se subjekti i rivlerësimit ka pasur marrëdhënie miqësie me shtetasin I. M. përpara se ky i fundit të kryente pagesën në shumën prej 14.000 eurosh në llogarinë bankare të Universitetit të {***}, Holandë për llogari të djalit të subjektit, O. P., në gusht të vitit 2016. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në shpjegimet dhënë Komisionit, se i ishte drejtuar z. I. M. si person pa probleme me ligjin dhe si biznesmen, bien në kundërshtim me sa deklaroi shtetasi I. M. në përgjigjet e datës 13.04.2019, drejtuar Komisionit, se me subjektin *ka një marrëdhënie korrekte shoqërore, e bazuar në respekt reciprok që përgjatë viteve ka ardhur duke u forcuar.*

45. Konflikti i interesit, sipas nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike. Një ndër rrethanat që mund të dëshmojnë konfliktin e mundshëm të interesit, janë *marrëdhëniet e njohura të miqësisë*¹.
46. Në dy procedimet penale ndaj shtetasit I. M., nr. {***} të vitit 2014 dhe nr. {***} të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, nuk ka njoftuar Prokurorin e Përgjithshëm për shmangien e konfliktit të interesit, si detyrim ligjor i parashikuar në nenin 3/ç të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionim e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Neni 3/ç “Shmangia e konfliktit të interesit”:*
1. *Drejtuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor, drejtuesit të prokurorisë pranë gjykatës së apelit, prokurorit të apelit, prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme apo Prokurorit të Përgjithshëm, kur gjendet në një çështje penale në rastet e parashikuara në nenet 16 e 17 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, i ndalohet t'i japë urdhra dhe udhëzime, me shkrim, prokurorit të çështjes apo të ndikojë në çdo mënyrë tjetër.*
 2. *Në këtë rast drejtuesi në konflikt interesi njofton, me shkrim, Prokurorin e Përgjithshëm. Prokurori i Përgjithshëm, kryesisht ose me kërkesë, vendos me shkrim për përjashtimin e drejtuesit në konflikt interesi nga procedura e dhënies së urdhrave dhe udhëzimeve. Në këtë vendim, Prokurori i Përgjithshëm cakton nëse dhe në ç'pjesë kanë vlerë veprimet e kryera në bazë të urdhrave dhe udhëzimeve të dhëna më parë nga drejtuesi në konflikt interesi. [...].*
47. Sa i përket procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, bazuar në nenin 17, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale, që parashikon *heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie*, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga kjo çështje, për të mos vepruar kështu në kushtet e konfliktit të interesit.
48. Në mbështetje të sa më sipër, trupi gjykues gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit në vendim, se *subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi I. M. kanë pasur njohje të hershme, lidhje miqësore dhe interesi, dhe se subjekti nuk ka ndërmarrë asnjë nga veprimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndodhjen në situata të mundshme apo faktike të konfliktit të interesit.*
49. Pretendimi i subjektit në ankim se *edhe në kushtet siç konkludon Komisioni, duhet të mbaheshin parasysh rrethanat lehtësuese të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe nenin 95 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues vlerëson që nuk qëndron, pasi subjekti është ndodhur më shumë se një herë në situatën e konfliktit të interesit në të paktën tri raste, të analizuara më sipër.*
50. Në konkluzion të analizës së procedimeve penale më sipër dhe veprimeve respektive të subjektit të rivlerësimit si prokuror dhe drejtues prokurorie, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, të cilin nuk e ka evituar/shmangur sipas parashikimeve të nenit 3/ç, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për

¹ Neni 5, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, përkatësisht germa “dh”, nënpika “v”.

organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë kryesisht për procedimin nr. {***}, të vitit 2014, dhe si prokuror i çështjes penale nr. {***} prot., viti 2015, kur ekzistonin shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie, në zbatim të nenit 17, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale. Vazhdimësia e lidhjes miqësore të subjektit me këtë individ dëshmohet edhe nga udhëtimet turistike të kryera prej tij dhe të birit në Greqi dhe Francë, ftesa e bërë nga z. I. M. djalit të subjektit për të vizituar Marsejën, në Francë, ftesë për subjektin e rivlerësimit në Selanik, Greqi, e më pas financimi i pagesës së shkollës së djalit të subjektit në një universitet në Holandë. Nëpërmjet ndjekjes personalisht apo nëpërmjet prokurorëve nën drejtimin e tij dhe zgjidhjes së çështjeve penale në të cilat ky individ apo biznesi i tij ishin palë dhe më pas përfitimi i vlerës prej 14 mijë eurosh për shkollimin, qoftë edhe përkohësisht, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime të cilat edhe veçmas apo në tërësi me elementet e shtjelluara më sipër, cenojnë besimin e publikut.

51. Në këtë vlerësim, trupi gjykues ka në konsideratë edhe shtjellimin e konceptit të paanësisë [vlera nr. 2 dhe nënpjesët e saj], sipas Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, të cilat zbatohen edhe për prokurorët. Paanësia është esenciale për ushtrimin e detyrës. Ajo gjen zbatim jo vetëm në vendimmarrje, por edhe në procesin që paraprin atë. Perceptimi i mungesës së paanësisë gërryen besimin e publikut². Testi i zbatuar rregullisht është nëse një vëzhgues i arsyeshëm, i cili e sheh çështjen në mënyrë reale dhe praktike, do të (ose “mund të”) perceptonte një mungesë paanësie nga gjyqtari³. Gjyqtari duhet të japë dorëheqjen nga pjesëmarrja në një procedim në të cilin është e pamundur të vendosë në mënyrë të paanshme ose në të cilin një vëzhguesi të arsyeshëm mund t’i duket se gjyqtari e ka të pamundur të vendosë me paanësi [vlera 2, pika 2.5].
52. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij në lidhje me trajtimin e procedimeve penale në ngarkim të z. I. M., në kushtet e një marrëdhënie miqësie me këtë të fundit, përfshirë edhe pagesën e shkollimit të personit të lidhur në vlerën 14.000 euro të pamaterializuar me dokument ligjor në momentin e financimit, ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, përgjatë ushtrimit të detyrës së tij si prokuror.

B. Vlerësimi i Kolegjit për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

53. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se nga subjekti janë kryer pasaktësi në deklaram, në mënyrë të përsëritur, veprime të cilat kanë si qëllim përpjekjen e subjektit për t’i paraqitur këto deklarime në mënyrë jo të saktë, që në vetvete përbëjnë cenim të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë nga subjekti i rivlerësimit. Më konkretisht:

Për pasurinë, automjet tip, “BMW”, i vitit 2006, me targa {}***

54. Për këtë pasuri, Komisioni në vendim ka dalë në përfundim se, referuar analizës ekonomike të Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit në përputhje me deklaramet e bëra prej tij. Nga hetimi rezultoi se ka pasaktësi në deklarimin në lidhje me burimin financiar të përdorur për blerjen e automjetit tip “BMW”, por që nuk kanë pasur për qëllim fshehje apo deklarim të rremë të subjektit.

² Paragrafi 55 i Komentarit mbi Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore:

https://www.unodc.org/documents/nigeria/publications/Otherpublications/Commentry_on_the_Bangalore_principles_of_Judicial_Conduct.pdf.

³ Paragrafi 56 i materialit të sipërcituar.

55. Në deklaratën për rivlerësim e pasurisë vetting, personi i lidhur, djali i subjektit, O. P., deklaroi pasurinë automjet i markës “BMW” (autoveturë), prodhim i vitit 2006, me targë {***}, blerë me kontratën nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 28.01.2015. Si burim krijimi të kësaj pasurie, O. P. ka deklaruar: të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit të markës “SMART” me targë {***} [...]. Po në këtë deklaratë, për automjetin “SMART”, personi i lidhur deklaroi: automjeti i mësipërm është rishitur në datë 24.12.2015, me kontratë shitje nr. {***} rep., dhe {***} kol., kundrejt vlerës 6000 (gjashtë mijë euro), shumë e cila është përdorur për të njëjtin qëllim, për blerje automjeti të markës “BMW” [...].
56. Pasuria objekt shqyrtimi është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për herë të parë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, si pasuri e shtuar: Automjet i markës “BMW”, viti 2006, me targë {***}, përfituar me kontratë blerje nr. {***} rep., {***} kol., në vlerën 6000 (gjashtë mijë) euro (shumë e cila zbritet nga shitja e automjetit të markës “SMART”, me targë {***}). Po në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit deklaroi pasuri e shtuar, shumë monetare 6.000 euro, përfituar nga shitja e automjetit të markës “SMART”, me targë {***}, me kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., në vlerën 6.000 euro.
57. Sa i takon burimit financiar për blerjen e pasurisë automjet i markës “BMW”, më datë 28.01.2015, si subjekti, ashtu edhe personi i lidhur, O. P., deklaroi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit të markës “SMART”, me targë {***}. Blerja e automjetit të markës “BMW”, vit prodhimi 2006, është formalizuar me kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2015, me shitës B. I. dhe blerës O. P., në vlerën 6.000 euro, likuiduar tërësisht midis palëve jashtë kësaj zyre noteriale. Shitja e mjetit “SMART”, me targë {***}, vërtetohet me kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.12.2015, përcjellë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 23.05.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, ku figuron shitës O. P. dhe blerës shtetasi A. Sh., në vlerën 6.000 euro, paguar jashtë zyrës noteriale, palët nuk kanë kontestim për çmimin dhe automjetin, përcaktohet shprehimisht në kontratë.
58. Nga analizimi i akteve të sipërcituara të administruara në dosje, trupit gjykues i rezultoi që automjeti i markës “BMW”, është blerë nga O. P. më datë 28.01.2015, me kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., ndërsa mjeti i markës “SMART”, tip “FORTWO”, të jetë shitur nga O. P. datë 24.12.2015, me kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol. Nga datat e kryerjes së këtyre transaksioneve, rezultoi se të ardhurat e përfituara nga shitja e mjetit “SMART” më 24 dhjetor 2015, nuk mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e mjetit “BMW” më 28 janar 2015, blerë rreth 11 muaj përpara shitjes së automjetit “SMART”, tip “FORTWO”.
59. Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni për këtë fakt në përgjigjet e datës 29.03.2019, lidhur me burimin e krijimit të shumës 6000 euro për blerjen e automjetit “BMW” më datë 28.01.2015, pra 11 muaj përpara se O. P. të shiste automjetin “SMART” më datë 24.12.2015, subjekti përgjigjet se burimi i krijimit për blerjen e automjetit ka qenë gjendja cash që dispononte në shtëpi. Subjekti shpjegon se sa ka deklaruar ka pasur si qëllim të sqarojë se bilanci nuk ka ndryshuar dhe shuma e pakësuar prej 6000 eurosh në janar 2015 nga blerja e mjetit “BMW”, me targë {***}, është rishtuar përsëri në dhjetor 2015 nga shitja e mjetit të markës “SMART”, po në çmimin 6.000 euro. Në shpjegimet e dhëna pas kalimit të barrës së provës me rezultatet paraprake të hetimit administrativ, subjekti deklaroi se në deklaratën e pasurisë vetting ka qenë i pasaktë dhe sqaroi se burimi i krijimit të shumës 6000 euro për blerjen e automjetit të markës “BMW”, me targë {***}, është gjendja në cash që dispononte në banesë.
60. Në kuptim të përcaktimit në pikën 7 të udhëzimit nr. {***} prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në

pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, *Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, për çdo pasuri, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre. Trupi gjykues, në referim të këtij përcaktimi, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur me të, O. P., në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë “vetting”, duhet të kishte deklaruar burimin financiar në momentin e blerjes së automjetit “BMW”.

61. Në përfundim për pasurinë automjet tip, “BMW”, i vitit 2006, me targa {***}, blerë me kontratën nr. {***}, datë 28.01.2015, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “vetting” lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me sa parashikon neni 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

Për pasurinë automjet tip “BMW”, viti i prodhimit 2000, me targa {}***

62. Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarimin periodik të vitit 2007 dhe atë të vitit 2008 lidhur me deklarimin e gjendjes cash dhe blerjen e automjetit. Subjekti ka deklaruar se ka blerë automjetin në vitin 2007 duke deklaruar edhe shpenzimet në shumën prej 500.000 lekësh, por që në fakt gjatë hetimit rezultoi se është paguar në datën 8 shkurt 2008.

*Komisioni nuk konstatoi ndonjë situatë të konfliktit të interesit ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasve E. H., familjarëve të tij, si dhe ndaj shoqërisë në administrim të familjarëve të tij, si M. H. (i ati), E. H., (i vëllai) dhe shoqërisë “{***}” ShPK.*

63. Nga analizimi i deklaratës së pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *automjet i markës “BMW”, prodhim i vitit 2000, me targë {***}, blerë me kontratën nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 08.02.2008. Burimi i të ardhurave: nga kursimet nga paga. Në vlerën 500.000 lekë. Automjetin e kam shitur pa kontratë në vitin 2012 për arsye se kishte probleme me dokumentacionin dhe nuk mund të pajisesh me certifikatë pronësie, e kam shitur dhe kam përfituar të ardhura në vlerën 280.000 lekë.*

64. Fitimi i pronësisë së subjektit të rivlerësimit mbi këtë automjet, është bërë përmes kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.02.2008, me shitës E. H. dhe blerës Arben Pasho, autoveturë “BMW”, me targë {***}, në vlerën 500.000 lekë. Referuar informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve e Transportit Rrugor me shkresën nr. {***} prot., datë 03.01.2019 dhe dokumentacionit shoqërues, ky automjet figuron i regjistruar në pronësi të z. E. H. që prej dhjetorit 2004 dhe nuk është regjistruar pranë kësaj drejtorie brenda afatit 10-ditor të parashikuar nga dispozitat e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, në emër të subjektit të rivlerësimit.

65. Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni për të shpjeguar arsyen e mosdepozitimit të kontratës së blerjes së këtij automjeti pranë DPSHTRR, nga viti 2008 kur është blerë deri në vitin 2012 kur është shitur, dhe arsyen e mosndryshimit të pronësisë, kur dispozitat e Kodit Rrugor parashikojnë afatin 10-ditor si detyrim i depozitimit të kontratës për ndryshimin e pronësisë, subjekti në përgjigjet e datës 18.01.2019 shpjegon se mosndryshimi i pronësisë sipas detyrimeve të Kodit Rrugor përbënte shkelje administrative, por në fakt në asnjë rast nuk kishte pasur penalitet për faktin e mosndryshimit të pronësisë. Po sipas subjektit, mosndryshimin e pronësisë nuk e ka bërë dhe për arsye se nëse ndryshonte pronësinë mjeti do të merrte targën e qytetit të Gjirokastrës “Gj”, sipas gjendjes civile të subjektit të rivlerësimit dhe në atë periudhë, sipas subjektit, në akset e rrugëve kombëtare ka pasur

shërbime të shtuara të policisë rrugore, të cilat ndalonin vend e pa vend drejtuesit e mjeteve, shpesh dhe në mënyrë abuzive, dhe drejtuesit e automjeteve me targë të Tiranës kishin privilegjin të mos ndaleshin si ato të qyteteve të tjera. Sipas subjektit, ka qenë praktikë që punonjësit e qarkullimit rrugor ngurronin të ndalnin mjete me targë të Tiranës, pasi kishte probabilitet të përballeshin me persona me influencë.

66. Po në të njëjtin pyetësor, pyetjes së Komisionit se cili ishte problemi me dokumentacionin e mjetit, datën kur u konstatua ky problem dhe si u bë e mundur shitja e mjetit kur kishte probleme dokumentacioni, subjekti i përgjigjet se kur e ka blerë automjetin më datë 08.02.2008, sipas kontratës noteriale, ishte me dokumentacion të rregullt, por tre muaj më pas, më datë 08.05.2008, ishte përfshirë në një aksident në rrugën {***}-Gjirokastër, ku mjete u dëmtua rëndë, ku rezultoi fajtor drejtuesi D. M. Në datën 17.02.2009, automjeti i parkuar ishte goditur nga furgoni me targë “{***}”, për të cilën rezultoi fajtor drejtuesi i automjetit të policisë, shtetasi B. M. Këto dy goditje, sipas subjektit, shkaktuan probleme mekanike dhe veçanërisht në shasinë e mjetit. Subjekti deklaroi se më pas këtë automjet ia shiti vëllait, punonjës policie, inspektor në Vlorë, z. A. P., i cili në atë kohë lëvizte me një mjet pa dokumente, sepse nuk kishte mundësi financiare të paguante doganën, e cila kapte për afërsisht vlerën e blerjes së mjetit. Në këto rrethana, në gusht të vitit 2012, i vëllai i subjektit ka shitur mjetin e vet Benz pa targa dhe ka blerë mjetin me targë {***}, por pa akt noterial.
67. Referuar rrethanave më sipër, rezultoi se subjekti ka përdorur një automjet në kundërshtim me nenin 93 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili në pikat 3, 4 dhe 5 të tij parashikon se: *3. Cilido që nuk respekton dispozitat e përcaktuara nga ky nen, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga dhjetë mijë deri në dyzet mijë lekë. 4. Cilido që qarkullon me një mjet, për të cilin nuk është kërkuar, brenda afatit të caktuar në pikën 1 dhe 2, azhurnimi ose rinovimi i lejes së qarkullimit dhe i certifikatës së pronësisë, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë. 5. Leja e qarkullimit i merret menjëherë atij që kryen shkeljet e parashikuara në pikën 3 dhe i dërgohet zyrës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që merr masa për rinovimin e saj pas zbatimit të dispozitave që janë shkelur.*
68. Në mbështetje të sa më sipër, përpos faktit që subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 93 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, por duke vlerësuar dhe arsyet e dhëna prej tij mbi mosndryshimin e pronësisë dhe targimit të automjetit, trupi gjykues çmon se këto veprime apo mosveprime reflektojnë një sjellje të papërshtatshme për pozicionin e tij, duke shkelur rregullat e etikës së prokurorit, i cili gjatë ushtrimit të funksionit në çdo kohë duhet të respektojë ligjet dhe t’u bindet akteve të organeve ligjzbatuese, mosrespektimi i ligjit është i papranueshëm për cilindo, ndërsa në rastin e një prokurori është edhe më i papranueshëm pasi cenon besimin e publikut tek organet e drejtësisë.
69. Për pasurinë automjet tip “BMW”, me targa {***}, blerë me kontratën nr. {***}, datë 8.2.2008, të deklaruar nga subjekti të shitur pa kontratë në vitin 2012 për arsye se kishte probleme me dokumentacionin dhe nuk mund të pajisej me certifikatë pronësie, trupi gjykues vlerëson se, së pari, subjekti ka përdorur një automjet pa e regjistruar në organin kompetent në emrin e tij, kur ky automjet figuron në pronësi të shtetasit E. H., *subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë lidhur me pronësinë mbi këtë automjet në deklaratën e pasurisë “vetting”, në kundërshtim me sa parashikon neni 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.*

Lidhur me përdorimin e shumës 1.483.529 lekë ose 10.500 euro

70. Në deklaratën e pasurisë vetting, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, deklaroi: *shuma [...] e tërhequr nga Tirana Bank është depozituar në depozitë cash në Intesa San Paolo Bank, në datë 26.08.2008, pasi interesat në këtë bankë kanë qenë më të larta. Është derdhur shuma 1.100.000 lekë si depozitë me afat të rinovueshëm automatikisht dhe në datë 30.08.2013, në këtë llogari është në shumën 1.483.529,68 lekë [...] e konvertuar në euro është në shumën 10.500 euro. Me shumën e mësipërme është paguar garancia e jetesës së djalit O. P. si student në Universitetin e {***} në Holandë. Kjo shumë është transferuar në llogarinë [...] në datën 26 prill 2016 nëpërmjet BKT Dega Gjirokastër.*
71. Në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur O. P. deklaroi se, për Universitetin {***} në Holandë, në llogarinë e studentit O. P. është paguar në formë garancie për ushqim dhe strehim (garanci jetese) shuma 10.500 euro. Kjo shumë është transferuar në [...], datë 26 prill 2016, nëpërmjet BKT ShA, Dega Gjirokastër dhe janë kursime familjare të prindërve, të deklaruara pranë institucionit tuaj (ILDKPKI) në mënyrë periodike ndër vite, pasi shuma e mësipërme ka qenë prej vitesh e depozituar në bankat e nivelit të dytë në Gjirokastër.
72. Lidhur me burimin e krijimit të shumës 10.500 euro, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016 se: *burimi i kësaj shume janë kursime familjare të deklaruara pranë institucionit tuaj ndër vite dhe kanë këtë historik: depozitë [...] në Tirana Bank, Dega Gjirokastër [...] çelur më 09.08.2000, me shumë fillestare 100.000 lekë kursime. Tërheqjet, derdhjet, si dhe shtesat ndër vite janë nga kursimet nga pagat dhe interesat bankarë. Më datë 25.08.2008, balanca e kësaj llogarie ka qenë 1.152.822,54 lekë. Shuma më sipër, e tërhequr nga Tirana Bank, është depozituar cash në Intesa SanPaolo Bank më datë 26.08.2008, pasi interesat në këtë bankë kanë qenë më të larta. Është derdhur shuma 1.100.000 lekë, si depozitë me afat të rinovueshëm automatikisht, dhe më datë 30.08.2013 balanca e kësaj llogarie është në shumën 1.483.529,68 lekë, e konvertuar në shumën 10.500 euro. Këtë shumë, subjekti i rivlerësimit e deklaroi në deklaratën e pasurisë vetting si burim për garancinë e jetesës së djalit, paguar Universitetit {***}, Holandë.*
73. Nga analizimi i deklaratës së interesave privatë të vitit 2013, po të njëjtën shumë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja, e kanë deklaruar si vijon: *kursime të deklaruara ndër vite: Tërheqje nga Intesa San Paolo Bank e shumës e cila ka qenë e depozituar në këtë degë, 1.483.529,68 lekë, për efekt të blerje banese, e cila duhet të blihet në fund të vitit 2014 ose në 2015 pas grumbullimit të shumës së nevojshme.*
Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *shuma 12.000 euro në banesë + 400.000 lekë kursime nga viti 2013 + 300.000 lekë në BKT ShA, por nga shuma e mësipërme është zbritur shuma cash 7.410 euro për blerje automjeti "SMART", 1.000 euro për blerje varke peshkimi dhe 200.000 lekë që i dërgohen O. [...] varkë peshkimi, gomone e përdorur, blerë në vitin 2014, në shumën 2.000 euro me shtetasin Dh. K., banor në fshatin {***}, Gjirokastër.*
74. Për sa i përket shumës 12.000 euro në banesë, me përgjigjet e datës 19.04.2019, të pyetësorit të Komisionit, subjekti sqaron se *shuma e deklaruar si kursime, 12.000 euro, përbëhet nga shuma 1.483.530 lekë e tërhequr nga "Intesa SanPaolo" në datë 30.08.2013, shumë e cila ka si burim të ardhurat ndër vite nga pagat si edhe kursimet e vitit 2014, kursime të cilat janë në shumën 250.000 lekë. Në total, kjo shumë në lekë është 1.733.530 lekë, sikurse edhe e kam deklaruar. [...]. Shuma 1.483.530 lekë, e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2014, nuk është prekur, pra nuk është përdorur për blerjen e automjetit "SMART" dhe as të varkës së peshkimit (gomones).*

Në shpjegimet e dhëna për rezultatet paraprake të hetimit administrativ, subjekti sqaron se në deklarin periodik vjetor të vitit 2016, kam qenë i paqartë në sqarimin e pagesës së shumë 10.500 euro, për pagesën e shpenzimeve të jetesës së shkollimit të djalit tim O. P. Në fakt, realiteti është (dhe këtë kam dashur të shpreh në sqarimet e mia në deklarin periodik vjetor) se kjo shumë është plotësuar si më poshtë: 1.300.000 lekë (9.300 euro) janë ulur nga gjendja “cash” e mbartur nga viti 2015 dhe pjesa tjetër (1.200 euro) nga pagat e vitit 2016. Në këtë moment, gjendja “cash” bëhet zero. Në këto rrethana, KPK duhet të bazohet në përgjigjet e dhëna nga ana ime në pyetësorët që më ka dërguar dhe jo në deklarinet periodike vjetore [...].

75. Mbështetur nga sa konstatuar më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore lidhur me përdorimin e shumë 1.483.529,68 lekë, tërhequr nga banka Intesa SanPaolo Sh.A, në gusht të vitit 2013, pasi në deklaratën e interesave privatë të vitit 2014 e deklaroi këtë shumë si burim krijimi të automjetit “SMART” dhe mjetit lundrues blerë në vitin 2014, ndërsa në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, në deklaratën e pasurisë vetting dhe në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision deklaroi që shuma 1.483.529,68 lekë është përdorur për pagimin e garancisë së jetesës në shumën 10.500 euro Universitetit {***}, Holandë, për djalin O. P., më 23 prill 2016.
76. Duke marrë në konsideratë, faktin që ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 5 të tij, i ka dhënë deklaratave të interesave privatë dhe pasurorë të paraqitura në ILDKPKI cilësinë për t’u përdorur si provë, trupi gjykues, duke konsideruar provë deklaratën e interesave privatë të vitit 2014, vlerëson se për shumën 1.483.529 lekë ose 10.500 euro, subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “Vetting” lidhur me përdorimin e kësaj shume, në kundërshtim me sa parashikon neni 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

Për pasurinë apartament me sipërfaqe 76 m², në Vlorë, në bashkëpronësi

77. Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar pjesën e tij dhe të bashkëshortes në bashkëpronësi, në apartamentin e ndodhur në qytetin e Vlorës (në deklaratat e pasurisë për 2003-2016, si dhe në deklaratën “vetting”). Mosdeklarimi i kësaj pasurie nuk rezultoi të jetë i qëllimshëm. Nga hetimi rezultoi se ata e kanë dhuruar pjesën e tyre në bashkëpronësi familjarëve të cilët realisht kanë banuar në atë pronë, pa kundërshpërblim.
78. Sa i përket kësaj pasurie, referuar informacionit të përcjellë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Vlorë, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.01.2019, rezultoi: pasuri e paluajtshme e regjistruar në favor të shtetasve “Ç. F. P., A. P., M. P. dhe A. P.”, pasuri e llojit apartament me sipërfaqe 76 m², me numër pasurie {***}, zk {***}, pasuri e cila në dt. 07.06.2017 ka kaluar në pronësi të shtetasve A. dhe L. P., me kontratë dhurimi.
- Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezultoi se kjo pasuri është blerë nga z. Ç. P. (babai i subjektit të rivlerësimit) nga Ndërmarrje Komonale Banesa e qytetit të Vlorës më datë 12.07.1993, në vlerën 14.360 lekë. Më datë 11.05.2017, çelet dëshmia e trashëgimisë nr. {***} rep. nr. {***} kol., për trashëgimlënësin Ç. F. P. (i cili kishte ndërruar jetë më 30.04.2001), duke caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë, A. P., A. P., A. P., Arben Pasho dhe A. Ç., me pjesë takuese 1/5 secili. Me urdhrin nr. {***}, datë 12.05.2012, të Regjistruesit të ZVRPP, Vlorë, regjistrohet dëshmia e trashëgimisë për këtë apartament dhe pasuria regjistrohet në emër të A. P. {***}, A. P. {***}, A. P. {***}, A. P. {***}, A. P. {***},

L. P. {***}, M. P. {***}. Përmes kontratës së dhurimit, ky apartament, më datë 17.05.2017, i dhurohet z. A. P. nga të gjithë bashkëpronarët e tjerë.

79. Me përgjigjen e datës 19.04.2019 të pyetësorit nr. 6 të Komisionit, ku kërkoheshin shpjegime nga Komisioni se përse subjekti nuk kishte deklaruar pjesën e bashkëpronësisë në këtë shtëpi në deklaratat e viteve 2003 deri në 2016, subjekti deklaroi se në datën 23.01.1993 ishte ndarë nga trangu familjar dhe prej vitit 1986 e aktualisht jeton në Gjirokastrë, duke mos pasur dijeni për procedurat e privatizimit të banesës prindërore në Vlorë dhe për faktin se ka qenë bashkëpronar në këtë banesë. Këtë fakt, subjekti pretendon ta ketë mësuar në muajin maj të vitit 2017. Kjo, sipas subjektit, ka qenë arsyeja që nuk e ka deklaruar në muajin janar të vitit 2017, dhe se nuk kishte asnjë arsye të mos e deklaronte.
80. Duke marrë në konsideratë datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë “vetting” më 30.01.2017, faktin që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kishin nënshkruar kontratën e dhurimit e cila u bë më datë 17.05.2017 dhe kanë pasur të drejta pronësie mbi apartamentin me sipërfaqe 76 m², të ndodhur në qytetin e Vlorës, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar këtë pasuri, në pjesën takuese.
81. Në përfundim, për pasurinë apartament me sipërfaqe 76 m², në Vlorë, në bashkëpronësi, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “vetting” lidhur me pjesën takuese mbi këtë pasuri, në kundërshtim me sa parashikon neni 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
82. Në konkluzion të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, për të gjitha shkeljet ligjore të cituara në këtë vendim, si:
- i. zëvendësimi në mënyrë të papërshtatshme i prokurorit në kundërshtim me nenin 27, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale;
 - ii. njoftimi i kallëzueses për vendimin e pushimit të çështjes pas një kohe të gjatë dhe jo brenda afatit ligjor, duke përcjellë më pas në mënyrë të gabuar dosjen në gjykatë, në shkelje të nenit 328, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale;
 - iii. shkeljet e konstatuara në procedimin penal të kundërvajtjes penale “Shpërdorimi i tokës”, parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal, si marrja e vendimit të mosfillimit të procedimit penal përpara marrjes së vendimit për kryerjen e ekspertimit dhe pa pritur rezultatet e aktit të ekspertimit, si dhe favorizimi i z. I. M. në këtë procedim penal;
 - iv. mosnjoftimi i Prokurorit të Përgjithshëm për shmangien e konfliktit të interesit përgjatë ushtrimit të detyrës së tij si drejtues prokurorie, si dhe mosheqja dorë apo përjashtimi nga çështja penale në ngarkim të z. I. M.;
 - v. deklarimi i pasaktë dhe në mënyrë të përsëritur i pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë “vetting”.
83. Trupi gjykues i Kolegjit, në përfundim të sa më sipër, çmon se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerëson se vendimi nr. 147, datë 16.05.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 147, datë 16.05.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Pasho.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 24.03.2021.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi - kundër

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi - kundër

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, kam votuar pro vendimit nr. 10 (JR), datë 24.03.2021, të marrë nga shumica e trupit gjykues për çështjen (JR) nr. 48/2019, datë 09.10.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Pasho, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 147, datë 16.05.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), por nuk jam dakord me konkluzionet e shumicës sa i takon kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimit profesional për sa më poshtë vijnë, me arsyetimin:

*i. Për pasurinë, apartament banimi, me sipërfaqe 123,5 m², ndodhur në {***}, Tiranë, përfituar nëpërmjet kontratës së porosisë të shtetases S. Z. në vitin 2014*

2. Vlerësoj se trupa gjykuese, gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, duhet të kishte marrë në analizë dhe vlerësuar këtë pasuri për shkak të sa arsyetuar më poshtë.
Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur, djali i subjektit, O. P., deklaron pasurinë *apartament me sipërfaqe 123,5 m², ndodhur në {***}, Tiranë*, dhe sqaron në vijim se *znj. S. Z. (gjyshja) nuk ka disponuar certifikatë pronësie pasi ka përpiluar kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2014, dhe ka paguar vlerën.*
Si burim krijimi të kësaj pasurie, O. P. ka deklaruar *testamentin nr. {***} rep., datë 14.09.2014, të trashëgimlënësës testamentare S. Z. (ndërruar jetë në muajin maj 2015).*
3. Nëpërmjet dokumentacionit justifikues, përcjellë bashkëlidhur *kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2014*, nga shoqëria “{***}” ShPK, vërtetohet që pagesa e kështit të parë në vlerën 15.000 euro është bërë nga S. Z. më datë 08.01.2008, pagesa e kështit të dytë në vlerën 11.000 euro është bërë nga S. Z. më datë 09.04.2008, dhe kështi i tretë në vlerën 5.600 euro është paguar më datë 23.06.2014, sipas mandatarkëtimit të lëshuar nga ProCredit Bank ShA në të njëjtën datë, me përshkrimin *depozitoi B. B. për M. P., pagesë kështi apartamenti*. Nga analizimi i mandatarkëtimeve të mësipërme, rezulton që:
 - i. S. Z., nëna e b/shortes së subjektit, ka kryer pagesat 15.000 euro më datë 08.01.2008 dhe 11.000 euro më datë 09.04.2008, rreth gjashtë 6 (gjashtë) vjet përpara datës 29.10.2014 të nënshkrimit të kontratës porosisë mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe shtetases S. Z..*
 - ii. Gjithashtu, konstatohet se kontrata e porosisë është formalizuar më datë 29.10.2014, pas pagimit të shumës totale prej 31.600 eurosh, dhe jo në datën 23.06.2014 të likuidimit të kështit të tretë nëpërmjet ProCredit Bank ShA.*

4. Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni në pyetësorin nr. 2⁴ se përse në përshkrim të mandatpagesës së kështit të tretë në shumën 5.600 euro, paguar në bankën ProCredit ShA, shkruhet “depozitoi B. B. për M. P.”, duke lënë kështu të nënkuptohet që ky kësht nuk është paguar nga vetë M. P. (bashkëshorte e subjektit) por nga shtetasi B. B., subjekti i rivlerësimit sqaron se:

*Në kushtet kur nëna e b/shortes, S. Z., pas vdekjes së b/shortit në shtator 2014, u përkeqësua në mënyrë të papritur dhe nuk mund të lëvizte normalisht, [...] u vendos të paguhej kështi i fundit prej 5.600 eurosh në ambientet e shoqërisë “{***}” ShPK, e ndodhur në {***}, [...] ka shkuar b/shortja M. P. në shoqërinë e djalit O. P.[...]. Shtetasi B. B. i ka dorëzuar (b/shortja) “cash” shumën e mësipërme, por nuk ka nënshkruar mandatarkëtim sepse veprimi i dorëzimit të kësaj shume është kryer në mirëbesim për shkak të lidhjeve miqësore që prindërit e b/shortes, por edhe familja ime dhe familjet e motrave të b/shortes kemi pasur dhe kemi ende me shtetasin A. D., i cili është pronar i shoqërisë “{***}” ShPK. Derdhja e shumës në bankë është kryer nga B. B. dhe mendoj se i është referuar pikërisht faktit se shumën e*

⁴ Pyetësori nr. 2, përgjigjur nga subjekti më 18.01.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. {***} prot., datë 23.01.2019.

mësipërme ia ka dorëzuar M. P. dhe jo S. Z.. Kontrata e porosisë [...] është formalizuar më datë 24.10.2014, pasi është paguar shuma totale, pra jo në momentin e dorëzimit të kështit të tretë i cili është paguar prej B. në ProCredit Bank ShA, më datë 23.06.2014.

5. I pyetur nga Komisioni lidhur me arsyen që pagesat e kështit të parë prej 15.000 eurosh dhe kështit të dytë prej 11.000 eurosh janë kryer nga S. Z. në vitin 2008, rreth 6 (gjashtë) vite përpara se të lidhej *kontrata e porosisë* në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur: *për shkak të marrëdhënieve miqësore nga ana e prindërve të b/shortes, i janë dorëzuar dy kështet e mësipërme vetëm me mandatarkëtime, pa u formalizuar kontrata e porosisë.*
Si burime financiare të ligjshme për të justifikuar shumën 31.600 euro, të paguar nga S. dhe E. Z. për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 123,5 m², ndodhur në {***}, Tiranë, subjekti ka deklaruar: *i) shuma 2.500.000 lekë dhënë S. dhe E. Z. nga A. dhe E. L. (Z.); ii) të ardhurat nga qiraja me shtetasin N. M. për periudhën 01.10.1993 – 31.03.2001, për çmimin 10.000 lekë/muaj; iii) kursimet nga të ardhurat nga pagat dhe pensionet e shtetasve E. dhe S. Z. për të njëjtën periudhë.*
6. Për të verifikuar ligjshmërinë e burimeve financiare të shtetasve E. dhe S. Z. për të paguar kështin e parë dhe të dytë të çmimit 31.600 euro, u analizua dokumentacioni justifikues i administruar, referuar të cilit S. Z., deri më 09 prill 2008, ka realizuar të ardhura nga pensioni në shumën 988.653 lekë, ndërsa b/shorti i saj, E. Z., ka realizuar për të njëjtën periudhë, të ardhura nga pensioni dhe paga në shumën 1.894.455 lekë.
Nëse nga të ardhurat e mësipërme zbrësim shpenzime për konsum familjar/jetike, përllogaritur në masën 66% të të ardhurave për periudhën dhjetor 1992 – dhjetor 1999, dhe sipas të dhënave të shkresës nr. {***} prot., datë 04.03.2019, që ILDKPKI i ka përcjellë Kolegjit për periudhën në vijim, rezulton *diferencë negative*. Pra, të ardhurat e S. dhe E. Z. deri më 08 janar dhe 09 prill 2008, kanë qenë të pamjaftueshme për të likuiduar kështin e parë dhe të dytë të çmimit të apartamentit në {***}, Tiranë.
7. Sa i takon burimit të dytë të pretenduar nga subjekti, *të ardhura nga dhënia me qira e pasurisë* me sipërfaqe 11,3 m² të përfutur nga S. Z. prej privatizimit të ish-Ndërmarrje e Shërbimeve Gjirokastër, në shumën 10.000 lekë në muaj, për periudhën 01 tetor 1993 - 31 mars 2001, të deklaruar nga shtetasi N. M. në *deklaratën noteriale* nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.01.2019, arsyetoj se:

Fakti që vetë deklaruesi sqaron të ketë lëshuar këtë deklaratë noteriale pasi *kontratën e qirasë mes palëve nuk e kanë formalizuar me një akt noterial*, tregon që mungon dokumentacioni justifikues ligjor, kontrata e qirasë e nënshkruar mes palëve ku të jenë specifikuar qartë shuma e qirasë mujore, afati kohor dhe detyrimi për likuidimin e tatimit për të ardhurat nga qiraja, si dhe, ndodhur në kushtet ku Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.02.2019, bën me dije Komisionin se nuk disponon të dhëna për të ardhurat nga qiraja si më sipër apo për likuidimin e detyrimeve tatimore që rrjedhin nga marrëdhënia e qirasë mes shtetasve S. Z. në cilësinë e *qiradhënëses* dhe N. M. në cilësinë e *qiramarrësit*, për periudhën 01.10.1993 – 31.03.2000, provojnë se të ardhurat e pretenduara nga qiraja nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës për t'u quajtur të ligjshme.

8. Sa i përket burimit tjetër të pretenduar të subjektit se për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 123,5 m², ndodhur në {***}, Tiranë, në vlerën 31.600 euro, *E. dhe S. Z. kanë përdorur si burim financiar shumën 2.500.000 lekë, dhënë nga bija e tyre, E. L. (Z.), dhe b/shorti i saj në muajin mars të vitit 2000*, arsyetoj se:

Referuar dëshmisë së bërë përpara noterit publik D. L. B., ndodhur në State of Indiana, County of Hamilton, U.S. më 16.01.2019, administruar në dosjen gjyqësore, A. dhe E. L. (Z.)

deklarojnë se më 18 shkurt 2000, shitën pronën e tyre “kafene” të ndodhur në lagjen {***}, Gjirokastër, në vlerën 3.900.000 lekë dhe në mars të të njëjtit vit, i dhanë pjesë të këtyre parave në shumën 2.500.000 lekë z. E. dhe S. Z. [...], të cilën ata e përdorën për të blerë një apartament në {***}, Tiranë.

Në dëshminë e dytë të bërë përpara noterit publik J. H., ndodhur në State of Indiana, County of Hamilton, U.S. më 02.02.2019, E. L. (Z.) dhe b/shorti i saj A. L. deklarojnë që *shuma 2.500.000 lekë iu dha E. dhe S. Z. (prindër të E. L. (Z.)) pa deklaratë noteriale [...] për të përmbushur nevojat ekonomike dhe shëndetësore që mund të lindnin, pa kusht, pra ishin dhuratë [...]*. Në dëshminë e dytë, E. L. (Z.) deklaroi shprehimisht se *nuk është dorëhequr nga e drejta ligjore e bashkëpronësisë së apartamentit të ndodhur në {***}, Tiranë.*

Në shpjegimet për pyetjen nr. 3 të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, subjekti sqaron se *kjo shumë (2.500.000 lekë), në dijeninë e tij, nuk u është kthyer shtetasve A. dhe E. L. (Zani), duke përforcuar kështu sa deklaruar më sipër nga E. L. (Z.).*

Referuar dëshmisë së bërë përpara noterit publik M. A. P., ndodhur në State of Indiana, County of Hamilton, U.S. më 21.03.2019, administruar në dosjen gjyqësore, A. dhe E. L. (Z.) deklarojnë dhe konfirmojnë se *kanë ndihmuar ekonomikisht prindërit e E. L. [...]*.

Në përgjigjet e datës 04.02.2019 të pyetjes nr. 1 të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, subjekti sqaron se shumën 2.500.000 lekë, A. dhe E. L. (Z.) ua kanë dhënë në *cash* prindërve të kësaj të fundit *për të garantuar mirëqenien në vijim, në rrethanat kur ata do të ndodheshin në ShBA e nuk do të kishin mundësi për t'u përkujdesur.*

Në përgjigjen e pyetjes nr. 1, të pyetësorit nr. 3⁵ të Komisionit, subjekti i rivlerësimit sqaron që pagesa e shumës 3.900.000 lekë, e përfituar nga A. dhe E. L. (Z.) dokumentohet me *kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.02.2000*, ku A. dhe E. L. kanë nënshkruar në cilësinë e palës *shitëse* dhe shtetasi Th. N. në cilësinë e palës *blerëse*.

Ndërsa dhënia e shumës 2.500.000 lekë b/shortëve E. dhe S. L. nga A. dhe E. L. (Z.) deklorohet me dëshminë e bërë përpara noterit publik D. L. B., ndodhur në State of Indiana, County of Hamilton, U.S. më 16.01.2019 (02.02.2019).

9. Bazuar në vlerësimin ligjor të kryer pas analizimit të dokumentacionit justifikues të administruar, u krye analiza financiare në Kolegj me konsideratë faktet:

Të ardhurat e pretenduara të jenë përfituar nga dhënia me qira e pasurisë së paluajtshme në pronësi të S. Z., ndodhur në lagjen “{***}”, Gjirokastër, në shumën 10.000 lekë/muaj, për periudhën 01.10.1993 deri më 31.03.2001 (total 900.000 lekë), nuk janë konsideruar burim i ligjshëm pasi *së pari*, nuk është dokumentuar marrëdhënia mes palëve apo/dhe pagesat e qirasë dhe *së dyti*, nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor likuidimi i detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiraja.

Lidhur me burimin tjetër financiar, shumën 2.500.000 lekë, pretenduar t’i jetë dhënë S. dhe E. Z. nga e bija E. L. (Z.) dhe b/shorti i saj A. L. në mars të vitit 2000, si rezulton nga dëshmia e datës 02.02.2019, marrëdhënia e dhurimit mes palëve është e pamaterializuar me kontratë dhurimi apo deklaratë noteriale në momentin e dhënies së shumës, pra mungon dokumentacioni justifikues ligjor me të cilin të provohet dhënia e saj, ndërkohë që shuma 2.500.000 lekë pretendohet nga subjekti të jetë mbajtur në shtëpi deri në vitin 2008, por nuk provohet sa deklorohet me dokumentacion justifikues ligjor.

⁵ Përgjigjet e datës 04.02.2019 të pyetësorit nr. 3 të Komisionit drejtuar subjektit, protokolluar nga Komisioni me nr. {***} prot., datë 07.02.2019.

10. Për të vlerësuar mundësinë financiare të E. dhe S. Z. për të kursyer shumat 15.000 euro ose 1.861.950 lekë, paguar si këst i parë më datë 08.01.2008; 11.000 euro ose 1.349.810 lekë më datë 09.04.2008 dhe 5.600 euro ose 784.952 lekë më datë 23.06.2014, nga të ardhurat e ligjshme të përfituara prej tyre, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi që *mundësia për të kursyer⁶ e prindërve të b/shortes së subjektit për periudhën 1994 – 09.04.2008, është në vlerën 456.730 lekë, pra më e vogël se shuma 26.000 euro apo 3.211.760 lekë, e likuiduar si shpjeguar më sipër.*
11. Sa i takon këstit të tretë, në shumën 5.600 euro, të likuiduar më datë 23.06.2014, sipas mandatar-këtimit të lëshuar nga Banka ProCredit ShA, me përshkrimin *depozitoi B. B. për M. P., pagesë kësti apartamenti*, nisur nga fakti që nuk janë dhënë sqarime nga subjekti për burimin e krijimit të kësaj shume, u krye analiza financiare në Kolegj për të vlerësuar nëse S. dhe E. Z. kanë pasur mundësi të justifikojnë me të ardhura nga burime të ligjshme shumën e sipërcituar, me konsideratë: *të ardhurat nga pensionet përfitur nga S. dhe E. Z. për periudhën 10.04.2008 – 23.06.2014 në shumën 2.505.810 lekë, shpenzimet për konsum/jetike për të njëjtën periudhë, përlllogaritur në vlerën 1.801.913 lekë sipas tabelës përmbledhëse të konsumit për frymë dhe familjarë sipas INSTAT për vitet 2003-2016, përcjellë Kolegjit me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2019, nga ILDKPKI-ja. Diferenca të ardhura minus shpenzime për konsum familjar/jetike minus këstin e tretë të paguar për likuidimin përfundimtar të apartamentit me sipërfaqe 123,5 m² ndodhur në {***}, Tiranë, rezulton negative dhe provon mungesë të burimeve financiare të ligjshme të S. dhe E. Z. për të krijuar shumën 5.600 euro ose 784.952 lekë gjatë periudhës 10.04.2008 – 23.06.2014.*
- Sa më sipër, pa përfshirë në analizë shpenzime për qira banese, paguar nga gjyshërit e O. P. për periudhën 01.01.2014 deri më 23.06.2014, në shumën 20.000 lekë/muaj x 6 muaj = 120.000 lekë, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjen e pyetjes nr. 7 të pyetësorit standard të Komisionit. Nëse në analizë përfshijmë edhe “shpenzimet për qira banese” si më sipër, atëherë diferenca negative e përlllogaritur më lart, do të thellonte në 201.054 lekë mungesën e burimeve financiare të ligjshme të S. dhe E. Z. për të blerë apartamentin në {***}, Tiranë.*

Edhe nëse konsiderohen të ligjshme të ardhurat nga qiraja, shuma e dhënë prindërve të b/shortes së subjektit nga e bija, E. L. (Z.), dhe b/shorti i saj, A. L. , nga analiza e kryer përsëri nuk rezultoi që E. dhe S. Z. të kenë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e këstit të tretë për likuidimin total të çmimit të apartamentit objekt shqyrtimi.

12. Nëse kësti i tretë konsiderohet të jetë likuiduar nga b/shortja e subjektit, znj. M. P., nga analiza financiare e kryer për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur, për të justifikuar me të ardhura nga burime financiare të ligjshme pagesën e këtij këstit në shumën 5.600 euro, më datë 23.06.2014, rezultoi që subjekti dhe personi i lidhur treguan mungesë të burimeve financiare të ligjshme.

Në vijim të sa arsyetuar më sipër, mungesa e burimeve financiare të ligjshme të S. dhe E. Z., për të likuiduar çmimin e apartamentit me sipërfaqe 123,5 m², ndodhur në {***}, Tiranë, pamundësia për të provuar me dokumentacion justifikues ligjor dhënien e shumës 2.500.000 lekë nga A. dhe E. L., prindërve të kësaj të fundit, deklarimi në pronësi në deklaratën e pasurisë *vetting*, nga djali i subjektit të rivlerësimit O. P., në pjesën takuese 100 %, më krijon

⁶ *Mundësia për të kursyer është përlllogaritur si diferencë e totalit të të ardhurave të përfituara nga E. dhe S. Z. për periudhën e analizuar, në shumën 2.883.108 lekë, me shpenzimet për konsum familjar/jetike të përlllogaritura në masën 66% të të ardhurave për periudhën dhjetor 1992 – dhjetor 1999, e sipas të dhënave të shkresës nr. {***} prot., datë 04.03.2019, që ILDKPKI-ja i ka përcjellë Kolegjit për periudhën në vijim*

bindjen se kjo pasuri është financuar nga subjekti i rivlerësimit Arben Pasho, për më tepër që nga analiza më sipër rezulton që znj. S. Z. nuk mund të dispononte me testament një pasuri për të cilën nuk ishte pronare e ligjshme.

ii. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

13. Lidhur me denoncimin e znj. L. P., përveç sa arsyetuar nga shumica e trupit gjykues në vendim, nga shqyrtimi i akteve të dosjes, në cilësinë relatores së çështjes, çmohet se duhet të ishte përfshirë në analizë edhe një element tjetër, shkelja ligjore e evidentuar, shpjeguar në vijim. Denoncuesja kishte bërë një kallëzim për të njëjtën vepër penale, atë të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, ndaj shtetasit H. K., më datë 09.10.2017, për të cilin prokurori i çështjes J. Ç., me vendimin e datës 27.10.2017, kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. {***} të vitit 2017, pasi fakti nuk parashikohej si vepër penale.

14. Me anë të shkresës {***} prot., datë 16.11.2017, vendimi për mosfillimin e procedimit penal iu njoftua shtetasve L. P. dhe H. K..

Në përgjigjet e dhëna ndaj rezultateve të hetimit administrativ në Komision, subjekti ka shpjeguar se, *pasi ka marrë njoftim për vendimin e mosfillimit të procedimit penal, shtetasja L. P. ka kontaktuar subjektin e rivlerësimit dhe ka ngritur akuza ndaj prokurorit J. Ç., pasi sjellja e tij ishte e njëanshme dhe favorizonte palën tjetër. Subjekti shpjegon se pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale të vitit 2017, nuk ka pasur tagër ligjor të shfuqizojë vendimin e mosfillimit të procedimit dhe i ka sugjeruar znj. P. që të bëjë përsëri kallëzim penal me të njëjtin objekt, duke arsyetuar se ishte një vepër penale vazhduese, përderisa pretendohet vetëgjyqësi.*

15. Sa më sipër, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe sugjerimin e tij i vlerësoj të pabazuara pasi, referuar dispozitave ligjore, në këtë rast shtetasja L. P. duhet të orientohet nga subjekti për të ankumuar në gjykatë vendimin e mosfillimit të procedimit penal sipas parashikimeve të nenit 291, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale dhe më pas do të ishte gjykata që do të vlerësonte nëse ky vendim ishte i drejtë apo procedimi duhet regjistruar e duhet të kryheshin hetime të nevojshme sipas drejtimeve të dhëna prej saj. Këshillimin në mënyrë të gabuar të kallëzueses për të riinvestuar prokurorinë për të njëjtën kërkesë dhe mbi të njëjtat fakte, ndërkohë që duhet ta kishte orientuar t’i drejtohej gjykatës, i vlerësoj si mungesë serioziteti në ushtrimin e funksionit si drejtues i prokurorisë, mungesë efikasiteti në punë pasi ka lejuar të vijojë çështja penale nga keqinformimi i viktimës, veprime të cilat bien ndesh me detyrat e tij si përfaqësues i interesit të individëve dhe publikut.

16. Lidhur me këtë kriter, vlerësoj se trupi gjykues duhet të kishte analizuar edhe denoncimin e bërë nga shtetasi K. Ll. për të cilin Komisioni edhe pse kishte hetuar duke administruar dosjen e procedimit penal, në vendimin përfundimtar nuk ka dalë me një konkluzion konkret për këtë denoncim, por vetëm me konstatimin se *çështja vijon ende të jetë nën hetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyrokastër*. Në lidhje me këtë fakt, vlerësoj se Komisioni duhet të kishte argumentuar konstatimet e evidentuara dhe të kishte dhënë konkluzionet e tij lidhur me to. Për këtë denoncim, arsyetimi i Komisionit në vendim është i paplotë.

Nga analizimi i akteve të dosjes, rezulton se denoncimi i shtetasit K. Ll., administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 11.09.2018, lidhet me kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, si *shkelje e etikës profesionale, zvarritje në proces*.

Nga dokumentacioni, rezultoi se babai i denoncuesit, Q. Ll., ka bërë kallëzim penal më datë 13.09.2017, regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër, për

veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” të parashikuar nga neni 186, paragrafi 1 i Kodit Penal, ku kallëzuesi ngre pretendimet se nga shtetasit M. L., ish-përgjegjës i Zyrës së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, ekspertëve topograf L. Gj. dhe P. H., si dhe punonjëses së Zyrës së Gjendjes Civile, N. C., i janë falsifikuar dokumentet e tij. Dosja për fillimin e hetimeve të çështjes penale me nr. {***} prot., datë 13.09.2017, i është kaluar prokurorit A. M. dhe, me transferimin e këtij të fundit në vitin 2017, dosja është marrë nga prokurori Arben Pasho. Sipas denoncimit, dosja penale edhe pse ka konsumuar kohën procedurale prej 9 muajsh, ende nuk është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

17. Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, është shprehur: *Duket sikur hetimet janë zgjatur më shumë se afati i vendosur nga ana juaj si prokuror i çështjes për përfundimin e tyre (data 27.05.2018), duke vijuar me korrespondenca me institucionet e tjera prej 1 viti e gjysmë për llogari të hetimeve më tepër se afati i parashikuar nga ligji dhe nuk ka një vendim për zgjatjen e hetimeve. Gjithashtu konstatohet se ende nuk ka urdhër regjistrimi të personit që i atribuohet vepra penale.*
18. Nga analizimi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti mbi rezultatet e hetimit administrativ, nuk rezulton që subjekti të ketë dhënë sqarime lidhur me këtë denoncim, ndërsa gjatë seancës gjyqësore, subjekti është shprehur se *çështja e referuar nga K. Ll. është civile dhe e ka një oficer i policisë gjyqësore që është duke kryer veprimet akoma.* Për sa më sipër, vlerësoj se në kushtet kur vetë subjekti pretendon që çështja është e natyrës civile, atëherë nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme e, për rrjedhojë, duhet të kërkonte pushimin e akuzës ose çështjes në zbatim të nenit 329/a të Kodit të Procedurës Penale.
19. Subjekti në ankim ka pretenduar se denoncimi i shtetasit K. Ll. nuk ka asnjë bazë faktike dhe ligjore pasi, referuar nenit 323/2 të Kodit të Procedurës Penale: *Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale [...],* ndërsa për rastin konkret, në regjistrin e njoftimeve nuk ishte shënuar emri i ndonjë personi që i atribuohet vepra penale për të mundësuar dhe konkluduar për zbatimin ose shkeljen e afateve të hetimit.
20. Sa i përket cilësimit “person të cilit i atribuohet vepra penale”, e gjejmë të trajtuar në mënyrë të qartë në vendimin unifikues nr. 3, viti 2002, të Gjykatës së Lartë ku është arsyetuar: *Termin “person të cilit i atribuohet vepra penale” e gjejmë në nenin 287 të K.Pr.Penale që flet për mënyrën si njoftohet e merr dijeni për veprën penale prokurori dhe policia. Kur njoftuesi mendon se e di se kush është autori i veprës penale, prokurori shënon në regjistrin që mbahet për njoftimin e veprave penale emrin e personit që tregon kallëzuesi, se është ose mund të jetë autor i veprës penale. Nuk ka asnjë dyshim se ky emërtim i përket fazës fillestare të procedimit penal. Termi “person të cilit i atribuohet vepra penale”, i marrë në kontekstin e nenit 287 të K.Pr.Penale plus momentin procedural në të cilin përdoret, kuptohet se nuk mund të barazohet as me termin “person ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe as me termin “i pandehur”. Emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur kallëzuesi mendon se e di se kush është autori i krimit. Por kjo nuk do të thotë se ai është vërtet autor i veprës penale. Nëse vërtet personi të cilit i atribuohet vepra penale është apo jo autor i veprës penale, do të dalë nga një hetim i plotë i gjithanshëm e në përputhje me ligjin [...] arrihet në përfundimin se figura procedurale e autorit të mundshëm të veprës penale që nga momenti i njoftimit të saj tek prokurori e deri në momentin e përfundimit të hetimeve (neni 327) evoluon nga “person të cilit i atribuohet vepra penale” në “person ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe së fundi në “i pandehur”, pavarësisht së çështja pushohet (neni 328) apo dërgohet për gjykim (neni 331).*

21. Nisur nga ky arsyetim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe nga fakti që në kallëzimin penal të bërë nga Q. Ll. janë evidentuar emrat e personave të cilët ai mendon se kanë konsumuar elementet e veprave penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, atëherë prokurori duhet të kishte regjistruar emrat e personave që u atribuohen veprat penale dhe nga ky moment të fillonin afatet e hetimeve, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale.
22. Vlerësoj se kryerja e veprimeve hetimore më tepër se një vit e gjysmë, pa marrë vendim për zgjatje afati hetimor, në shkelje të procedurave të parashikuara në këtë kod, konkretisht parashikimit në nenin 323, pika 2 e tij, si dhe vijimi i hetimeve kur vetë prokurori i çështjes vlerëson se jemi përpara një çështjeje me natyrë civile, sjell zvarritje të procesit hetimor.
23. Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, vlerësoj se kjo analizë duhet të ishte përfshirë në arsyetimin e vendimit të shumicës për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit Arben Pasho, si element që cenon besimin e publikut te drejtësia, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne – gjyqtarët Albana Shtylla dhe Sokol Çomo – kemi votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, në çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Arben Pasho kundër vendimit nr. 147, datë 16.05.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), nëpërmjet të cilit është vendosur lënia në fuqi e vendimit të mësipërm të Komisionit dhe është konfirmuar shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Arben Pasho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë.
2. Në mënyrë të përmbledhur, Komisioni ka mbështetur vendimin e tij të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit Arben Pasho, duke konkluduar se:

2.1 Konkluzioni përfundimtar për vlerësimin e kriterit të pasurisë

Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, që rezultoi në disa pasaktësi në deklaram dhe një mosdeklarim të pjesës takuese në një pasuri të paluajtshme, trupi gjykues, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, arrin në përfundimin se këto problematika nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm dhe nuk arrijnë deri në atë nivel që të përmbushin aplikimin e pikave 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në vlerësimin e tij, Komisioni mban parasysh edhe faktin se subjekti i rivlerësimit ka treguar gatishmërinë e tij të menjëhershme për të dhënë sqarime rreth fakteve të rezultuara nga hetimi, kur është pyetur nga Komisioni, po ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore duke krijuar bindjen se ai ishte i vërtetë në deklaramet e tij.

2.2 Konkluzioni përfundimtar për vlerësimin e kriterit të figurës

*Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Pasho, ka plotësuar në mënyrë korrekte deklaramtën për kontrollin e figurës, pasi pavarësisht dijenisë së tij lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2014, për veprën “Pastrim i produkteve të veprës penale”, formalisht, emri i shtetasit I. M., nuk figuron si person i regjistruar në regjistrin e veprave penale si autor i veprës penale dhe, për pasojë, ai nuk mund të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm në kuptim të pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar [...]”.*

Për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Pasho, Komisioni nuk pati asnjë të dhënë mbi veprimtarinë korruptive, apo mbi kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në vlerësim të provave të administruara, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka cenuar asnjë nga parimet e parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, apo të pikave 2 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

2.3 Konkluzioni përfundimtar për vlerësimin profesional

Nga vlerësimi i dokumenteve ligjore, kanë rezultuar disa mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit.

Në lidhje me situatën e konfliktit të interesit, konstatohet se të paktën në një rast subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

Nga vlerësimi tërësor i kriterit profesional, janë konstatuar mangësi dhe problematika, por trupi gjykues vlerëson se ato nuk janë deri në atë masë që të plotësojnë qëllimin e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, apo pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, arrin në përfundimin se pavarësisht se nuk u vlerësua që problematikat e konstatuara për secilin komponent përbëjnë më vete shkak për shkarkim nga detyra, duke u analizuar në tërësinë e tyre, në vlerësim të Komisionit, konsiderohet se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

Në përfundim, mbështetur në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni bëri vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Pasho, në vlerësimin e të tria kriterëve, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

3. Shumica e trupit gjykues në vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, për të gjitha shkeljet ligjore të cituara në paragrafin 82 të vendimit.
4. Sa u përket fakteve të rezultuara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe të analizuara edhe nga shumica në vendim, ato nuk do të citohen në mënyrë të detajuar, përveçse kur do të nevojiten gjatë arsyetimit në këtë mendim pakice.

I. Lidhur me shkeljet në kuadër të kontrollit të kriterit të pasurisë, të konsideruara si cenim i besimit të publikut sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016

5. Shumica në vendim ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, nga kontrolli i kriterit të pasurisë, ka rezultuar se ka bërë deklaram të pasaktë dhe në mënyrë të përsëritur të pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë “vetting”. Në vlerësimin e gjyqtarëve të pakicës, një konkluzion i tillë, në të cilin specifikohet ekzaktësisht se në cilat deklarime të subjektit të rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën “vetting”, nuk gjendet i pasqyruar në konkluzionet që ka dhënë Komisioni për secilën pasuri, por edhe në konkluzionin përfundimtar të tij⁷. Siç konstatohet nga përmbajtja e vendimit, Komisioni ka konkluduar përfundimisht se në vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, që rezultoi në disa pasaktësi në deklaram⁸, ndërkohë në arsyetim, në konkluzionet e dhëna në vendim për secilën pasuri, është konkluduar për pasaktësi nga subjekti i rivlerësimit Arben Pasho në deklaratën *vetting*, vetëm në kontrollin e pasurisë apartament me sipërfaqe 76 m² në Vlorë në bashkëpronësi⁹, si dhe për automjetin tip BMË, viti i prodhimit 2000, për pasaktësi në deklaramet periodike vjetore të pasurisë së viteve 2007 dhe 2008 për gjendjen *cash* dhe për blerjen e kësaj pasurie¹⁰. Lidhur me pasaktësitë në deklaramet periodike vjetore, nëse ato nuk janë të shoqëruara me mungesë burimesh të ligjshme, apo nuk janë përpjekje të subjektit për fshehje apo deklarim të rremë të pasurive të krijuara, Kolegji ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës ato nuk mund të mbahen në konsideratë për t’u kualifikuar si shkelje në kuadër të procesit të rivlerësimit, për rrjedhojë të gjejnë ndonjë kualifikim sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, pakica sjell në vëmendje se Komisioni për pasuritë e mësipërme, për të cilat ka konstatuar se ka deklarime të pasakta (por jo vetëm për këto konkluzione), në asnjë rast nuk ka konkluduar që subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së

⁷ Shih paragrafët e konkluzioneve për çdo pasuri në vendimin e Komisionit, faqet 6, 7, 10, 11, 12, 16, 18, 19, 22, 24 dhe 25. Edhe në rastin e pasurisë automjet tip BMW, viti i prodhimit 2006, blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2015, Komisioni ka konkluduar për deklarim të pasaktë për burimin e krijimit, por pa përcaktuar nëse kjo pasaktësi ka qenë sipas vlerësimit të tij në deklaramet periodike të pasurisë apo në deklaratën “vetting” (shih faqen 18 të vendimit).

⁸ Shih faqen 25 të vendimit të Komisionit.

⁹ Apartamenti i përfutur nga kontrata e privatizimit me prindërit dhe vëllanë, sipas kontratës së privatizimit 21.06.1993, e lidhur nga ati i tij Ç. P. me Ndërmarrjen e Komunale Banesave në Vlorë.

¹⁰ Faqja 23 e vendimit.

burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe për kryerjen e shpenzimeve për vitin kalendarik të cilit i përket krijimi i këtyre pasurive.

6. Për më tepër, në vlerësimin e gjyqtarëve të pakicës, Komisioni në konkluzionet e vendosura për secilën pasuri, por edhe në konkluzionin përfundimtar për kriterin e pasurisë, si dhe për zgjidhjen e çështjes, ka dështuar të përcaktojë se për cilat prej këtyre pasaktësive në deklarim, *konsiderohet se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia*¹¹. Gjithashtu, Komisioni ka përmbyllur konkluzionin përfundimtar të kriterit të pasurisë duke u shprehur se: *[...] Në vlerësimin e tij, Komisioni mban parasysh edhe faktin se subjekti i rivlerësimit ka treguar gatishmërinë e tij të menjëhershme për të dhënë sqarime rreth fakteve të rezultuara nga hetimi, kur është pyetur nga Komisioni, po ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore duke krijuar bindjen se ai ishte i vërtetë në deklarimet e tij.* Në këtë mënyrë, Komisioni ka pranuar që sjellja dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit Arben Pasho kanë pasqyruar të vërtetën, për më tepër ato janë marrë në konsideratë në vlerësimin dhe konkluzionet e Komisionit për pasaktësitë në deklarim, duke pranuar që ato nuk mund të sillnin pasoja për subjektin në kuadër të procesit të rivlerësimit.
7. Për pakicën, konkluzioni përfundimtar i Komisionit se, *në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve [...] konsiderohet se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia*, vlerësojmë se është i paarsyetuar, pasi Komisioni nuk ka qartësuar në vendim rastet/shkeljet konkrete që kanë rezultuar në kontrollin e kriterit të pasurisë, në bazë të të cilave subjekti është vendosur në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit Arben Pasho ka qenë tërësisht i paqartë lidhur me rastet apo shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit të kriterit të pasurisë, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin tërësor të çështjes, duke konkluduar për cenim të besimit të publikut te drejtësia, për rrjedhojë ai ka qenë në pamundësi për t’u mbrojtur dhe kundërshtuar Komisionin për këtë vlerësim nëpërmjet ankimit në Kolegj.
8. Bazuar në sa më sipër, pakica ka vlerësuar se në kushtet e një mungese arsyetimi dhe paqartësie në vendimin e Komisionit, lidhur me rastet/shkeljet konkrete të kriterit të pasurisë, të cilat janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuadër të gjykimit në Kolegj, i cili ka për objekt kontrollin e vendimit të Komisionit, bazuar në ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund të ketë një përcaktim dhe kualifikim të tyre rishtazi si veprime që cenojnë besimin e publikut te drejtësia. Ndryshe nga shumica, në gjyqtarët në pakicë kemi vlerësuar se duke bërë një përcaktim dhe kualifikim të tyre në Kolegj, gjykimi i vënë në lëvizje me ankimin e subjektit të rivlerësimit ka shtuar shkelje të reja për shkarkimin e tij sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuptim, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, vlerësojmë se përcaktimi nga Kolegji i rasteve/shkeljeve që konsiderohen në vlerësimin tërësor të çështjes, pa i dhënë të drejtën subjektit të rivlerësimit Arben Pasho për t’u mbrojtur lidhur me to, rëndon pozitën e subjektit të rivlerësimit në gjykim, në kundërshtim me parimin e *no reformatio in peius*, që garanton të drejtën e mbrojtjes së një subjekti në procesin e gjykimit në një shkallë më të lartë gjykimi.
9. Në përfundim, në vlerësimin e gjyqtarëve të pakicës, rastet/shkeljet e cituara nga shumica në vendim nuk mund të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

¹¹ Ashtu siç ka bërë në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, në konkluzionin lidhur me procedimet penale ndaj shtetasit I. M., faqe 34 e vendimit.

II. Lidhur me shkeljet në kuadër të kontrollit të kriterit të aftësive profesionale të konsideruara si cenim i besimit të publikut sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016

10. Ne gjyqtarët në pakicë çmojmë të theksojmë në fillim të arsyetimit të qëndrimit tonë lidhur me këtë nënçështje, se edhe në kuadër të kontrollit të kriterit të aftësive profesionale, Komisioni në konkluzionet e shprehura në vendim, për çdo dokument ligjor apo denoncim të paraqitur nga publiku që i është nënshtruar vlerësimit, si dhe në konkluzionin përfundimtar për kriterin e aftësive profesionale, apo për zgjidhjen e çështjes, ka dështuar të përcaktojë konkretisht se cilat prej mangësive të konstatuara gjatë procesit të rivlerësimit, janë konsideruar prej tij për të mbërritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia¹². Në këtë kuptim, gjyqtarët e pakicës theksojnë se dhe për kontrollin e këtij kriteri dhe konkluzioneve lidhur me të, vlen çdo konstatim dhe vlerësim i shtjelluar më sipër në pjesën I, paragrafët 7 dhe 8 të këtij mendimi pakice, për mënyrën se si duhet të arsyetonte dhe të qartësonte Komisioni rastet/shkeljet për të cilat do të zbatonte përcaktimet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84.2016.

Në vijim, po paraqesim qëndrimin tonë për shkeljet e listuara nga shumica në vendim, për të cilat është konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

11. **Lidhur me denoncimin e shtetasit A. S.**, siç rezulton nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore, konstatohet se prokurori i çështjes për procedimin penal nr. {***}, vitit 2011, S. Ç. është zëvendësuar nga prokurori J. Ç.. Procedimi penal i sipërcituar ka qenë i shtrirë në një periudhë kohore prej vitit 2011 deri më 31.10.2017, i shoqëruar me shumë veprime hetimore, por dhe vendime proceduriale nga prokurorët e çështjes, por dhe akte të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë¹³.

12. Në këtë mendim pakice do të ndalemi vetëm në analizën sa i përket faktit nëse kemi një zëvendësim në mënyrë të papërshtatshme të prokurorit të çështjes dhe jo në formën e kërkuar nga neni 27 i Kodit të Procedurës Penale. Pakica sjell në vëmendje që zëvendësimi i prokurorit S. Ç. nga çështja, është bërë pas shfuqizimit të vendimit të këtij prokurori për pushimin e çështjes, më datë 02.04.2013, nga Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë, e vënë në lëvizje me ankimin e shtetasit A. S.¹⁴. Siç rezulton nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit Arben Pasho, shtetasi A. S. kishte kontestuar veprimtarinë e prokurorit S. Ç. dhe, për këtë arsye, ai, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, me qëllim shmangien e paragjykitimit për zgjidhjen e çështjes, ka vendosur për zëvendësimin e këtij prokurori me prokurorin J. Ç.. Në kuptim të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit Arben Pasho ka konsideruar që vijimi i prokurorit S. Ç., si prokuror i çështjes, mund të përbënte për denoncuesin-kallëzues, në këndvështrim të verifikimit të testit objektiv dhe subjektiv, shkak të rëndësishëm njëanshmërie për zgjidhjen e saj.

Bazuar në aktet e administruara dhe sa më sipër argumentuar, ndryshe nga shumica, vlerësojmë se arsyeja e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, ka qenë e përshtatshme dhe e parashikuar në nenin 16, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale. Pakica, në mbështetje të qëndrimit të saj, sjell në vëmendje edhe faktin që vendimi procedural i fundit i marrë lidhur me çështjen, nga prokurori zëvendësues J. Ç., është konfirmuar përfundimisht me vendimin e datës 31.10.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë

¹² Përjashtim bën këtu vetëm rasti i arsyetuar dhe konkluduar në vendim nga Komisioni për konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit me z. I. M..

¹³ Siç është cituar nga shumica në vendim, subjekti i rivlerësimit ka të paktën një vendim prishje të vendimit të prokurorit të çështjes për “pushimin e çështjes” (datë 13.12.2011), në të cilin shprehet se e gjen atë të pabazuar në prova dhe në ligj, duke çmuar se veprimet hetimore nuk janë të plota dhe, në këto rrethana, konkluzioni i arritur në përfundim të hetimeve çmohet se është i gabuar.

¹⁴ Pra, një shfuqizim vendimi pushimi të prokurorit të çështjes S. Ç. për herë të dytë pas atij të bërë në vitin 2011 nga vetë subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë.

Gjirokastrë, duke nënkuptuar që veprimet hetimore të kryera nga prokurori vijues bindën gjykatën për drejtësinë e vendimit të pushimit të çështjes. Mungesa e një urdhri të nxjerrë nga subjekti i rivlerësimit për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, si dhe e shprehjes së pëlqimit të prokurorit të zëvendësuar në zbatim të nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale, të vlerësuara të ndërlidhura me qëllimin për të cilin ishte bërë zëvendësimi, vendimin e sipërcituar të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë¹⁵, si dhe mungesën e një ankimi nga prokurori S. Ç. për heqjen e tij si prokuror i çështjes, për gjyqtarët e pakicës, edhe pse nuk plotëson kërkesat e kësaj dispozite në këndvështrimin formal, i ka shërbyer zgjidhjes së drejtë dhe sa më të shpejtë të çështjes, duke plotësuar në këtë mënyrë qëllimin për të cilin publiku drejtohet tek organet e drejtësisë, si dhe pritshmëritë e tij nga këto organe. Mbi sa më sipër arsyetuar, vlerësojmë se mosnxjerrja e aktit formal sipas nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale, nuk mund të konsiderohet si një shkelje që duhet të mbahet në konsideratë në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

13. **Lidhur me denoncimin e znj. L. P.**, shumica ka konsideruar se veprimet e subjektit të rivlerësimit, si ai i këshillimit në mënyrë të gabuar i kallëzueses për të riinvestuar prokurorinë për të njëjtën kërkesë dhe mbi të njëjtin grup faktesh, si dhe njoftimi i kallëzueses për vendimin e pushimit të çështjes pas një kohe të gjatë dhe jo brenda afatit ligjor, duke përcjellë më pas në mënyrë të gabuar dosjen në gjykatë, në shkelje të nenit 328, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, konsiderohen si veprime që cenojnë besimin e publikut.
14. Pakica thekson se kallëzimi i znj. P. është i datës 12.12.2017, pra pasi kishin hyrë në fuqi ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale, të cilat kanë përcaktuar pavarësinë procedurale të prokurorëve të çështjes, si dhe kanë reformuar në mënyrë të rëndësishme rolin procedural dhe tagrat që kanë drejtuesit e Prokurorisë në lidhje me ndjekjen penale në prokuroritë që ata drejtojnë, duke i përjashtuar tërësisht ata nga përfshirja në vendimmarrje lidhur me një çështje penale në të cilën ata nuk janë caktuar si prokuror i çështjes. Për rrjedhojë, gjyqtarët e pakicës vlerësojnë se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë tagër ligjor për të shfuqizuar vendimin e prokurorit të çështjes për mosfillimin e procedimit penal, për të cilin znj. P. është ankuar te subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë.
15. Sa i përket njoftimit të vonuar në kohë të denoncueses-kallëzuese nga subjekti i rivlerësimit për vendimin e pushimit të çështjes penale, siç rezulton nga aktet e administruara, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar me vendimin e tij për pushimin e çështjes, njohjen me këtë vendim të të interesuarve, duke zbatuar në këtë mënyrë përcaktimet e nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale¹⁶. Sipas akteve të administruara, sekretaria dhe kancelari i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë nuk kanë zbatuar urdhërimet e dhëna nga prokurori i çështjes, subjekti i rivlerësimit Arben Pasho, në vendimin për pushimin e çështjes. Siç rezulton nga përmbajtja e vendimit, subjekti i rivlerësimit madje ka trajtuar edhe mënyrën se si mund të kundërshtohet ky akt nga palët e interesuara, bazuar në nenin 329 të Kodit të Procedurës Penale.

Për pakicën, lidhur me këtë njoftim të vonuar të vendimit të pushimit, ka një rëndësi të posaçme fakti që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në vendimin nr. 66, datë 25.02.2019, ka pranuar këtë vendim duke çmuar se veprimet hetimore janë të plota dhe prokurori i çështjes me të drejtë ka vendosur: *pushimin e çështjes penale nr. {***} në ngarkim*

¹⁵ *Vendimi i gjykatës ka rrëzuar kërkesën e z. A. S., për prishjen e vendimit të pushimit të prokurorit të çështjes, i cili, sipas nenit 328/1 të Kodit të Procedurës Penale, kishte konkluduar që "fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale".*

¹⁶ *Me vendimin e datës 15.07.2018, prokurori i çështjes, subjekti i rivlerësimit Arben Pasho, vendosi pushimin e çështjes penale nr. {***} në ngarkim të shtetasit H. K., për arsye se fakti i konstatuar nuk përbën vepër penale. Në këtë vendim ka urdhëruar: "Me këtë vendim të njihen të interesuarit të cilët në referim të nenit 329 kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Shkallës së Parë Gjirokastrë".*

të shtetasit H. K. për arsye se fakti i konstatuar nuk përbën veprë penale. Pra, edhe nëse znj. P. do të kishte ushtruar në kohë të drejtën për t'u ankuar për këtë vendim të prokurorit të çështjes, gjykata do të kishte vlerësuar se veprimet hetimore kanë qenë të plota, pra vendimi i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka qenë i drejtë.

- 16. Lidhur me situatën e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin I. M.,** pakica thekson se, për të konkluduar nëse subjekti i rivlerësimit Arben Pasho ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, nëpërmjet ushtrimit të tagrave ligjorë në tri çështje të cilat janë trajtuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër lidhur me këtë shtetas, vlerësimi duhet bërë bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”) në të cilin përcaktohet rrethi i interesave pasurore dhe gjendja e konfliktit të interesit, si dhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale në të cilat parashikohen kushtet dhe procedurat se si një prokuror duhet ta deklarojë dhe shmangë atë.
- 17. Ligji nr. 9367/2005** përcakton në nenin 5 të tij rrethin e interesave privatë, ku ndër të tjera përfshihen edhe marrëdhëniet e miqësisë¹⁷. Në nenin 3, shkronja “ç” e po këtij ligji, konflikti rast për rast i interesit përkufizohet si gjendja në konflikt interesi faktik, në dukje apo të mundshëm, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë. Bazuar në këtë përkufizim, si edhe në përmbajtjen e neneve 23 dhe 24 të këtij ligji, rezulton se në lidhje me evidentimin e konfliktit rast për rast të interesit, janë të rëndësishme dy çështje kryesore: a) duhet të ekzistojë shfaqja e një konflikti interesi në formën e konfliktit faktik, në dukje apo të mundshëm; b) konflikti rast për rast është i lidhur me një apo disa vendimmarrje të veçanta, pra, është i lidhur me vendimmarrjeje konkrete dhe rolin e zyrtarit në këtë vendimmarrje. Në çdo rast, konflikti rast për rast i interesit, sipas këtyre parashikimeve ligjore, duhet kuptuar si një papajtueshmëri momentale ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit, e lidhur me një vendimmarrje të caktuar, pra, që vendimmarrja e zyrtarit të jetë e ndikuar nga interesi i tij privat, i lidhur me këtë vendimmarrje.

Gjithashtu në nenin 13 të ligjit nr. 9367/2005, përcaktohet se: [...] 2. *Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas këtij kreu, bëhen vetëm për ato veprime, që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara, sipas rastit, në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe të legjislacionit që rregullon procesin e hetimit parlamentar [...].*

Bazuar në sa më sipër, pakica vlerëson se dispozitat që duhet të zbatohen për të përcaktuar gjendjen e konfliktit, si dhe mënyrën se si duhet zgjidhur ai, në rastet kur ekziston, për rastin konkret duhet të jenë nenet 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, për sa kohë që

¹⁷ *Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga:*

a) *të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;*

b) *çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;*

c) *dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;*

ç) *negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;*

d) *angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;*

dh) *marrëdhënie:*

i) *familjare apo të bashkëjetesës;*

ii) *të komunitetit;*

iii) *etnike;*

iv) *fetare;*

v) *të njohura të miqësisë apo të armiqësisë.*

veprimtaria e zyrtarit në këtë rast, e cila pretendohet se ka qenë në një situatë konflikti interesi, lidhet me veprimtarinë procedurale të subjektit të rivlerësimit Arben Pasho, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë apo të prokurorit të çështjes.

18. Në mbështetje të legjislacionit të sipërcituar, sipas rrethanave faktike të përshkuara në vendim¹⁸, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prokuror i çështjes në dy procedime penale, por ka qenë drejtues i Prokurorisë me tagra procedurale të miratimit të akteve të prokurorit të çështjes, ndërkohë që në procedimin penal me nr. {***} të vitit 2015, ka qenë edhe prokurori i çështjes. Rrethanat faktike të provuara gjatë hetimit administrativ, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit Arben Pasho, si dhe deklaratimet e z. I. M., në vlerësimin e pakicës nuk kundërshtojnë njëra-tjetrën, por provojnë që marrëdhënia ndërmjet subjektit dhe shtetasit në fjalë ka qenë një marrëdhënie korrekte shoqërore si bashkëqytetarë, e cila prej vitit 2016 e në vijim ka ardhur duke u përforcuar. Nga aktet e administruara, deklaratimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit Arben Pasho në kuadër të procesi të rivlerësimit në Komision, të cituara në vendim edhe nga shumica, nuk provohet që gjatë periudhës maj 2014 - gusht 2015, të ketë ekzistuar një marrëdhënie ndërmjet tij dhe z. I. M., e tillë që të cilësohej si marrëdhënie miqësie apo marrëdhënie interesi e çfarëdolloj forme tjetër, nga ato të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9367/2005, marrëdhënie kjo që do ta vendoste atë përkundrejt detyrimit për të hequr dorë nga tagrat procedurale që kishte në procedimet penale me nr. {***}, viti 2014; nr. {***}, viti 2015 dhe nr. {***}, viti 2015, në përputhje me përcaktimet e neneve 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenin 3, germa “ç” e ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionim e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 8737/2001”).
19. Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në pyetësorin standard të Komisionit, lidhur me udhëtimet e kryera prej tij gjatë periudhës 2011-2018, në të cilat ai është shprehur se ka kryer dy udhëtime me automjetin “Benz” me drejtues dhe pronar z. I. M.¹⁹, si dhe akte të tjera të administruara në kuadër të këtij procesi, nuk provojnë që këto udhëtime janë kryer para gushtit të vitit 2016²⁰, çfarë do të nënkuptonte një marrëdhënie të tillë mes tyre, që ishte përtej një “marrëdhënieje korrekte si bashkëqytetarë”, ashtu siç bashkërisht e kanë përkufizuar atë.
20. Bazuar në sa më sipër, pakica çmon se nuk është provuar një papajtueshmëri momentale e subjektit të rivlerësimit Arben Pasho në ushtrimin e një vendimmarrjeje dhe interesit privat të tij.

Për këtë arsye, pakica vlerëson se mungesa e provave për të provuar këtë fakt, e bën të pamundur që të konkludohet nëse subjekti i rivlerësimit Arben Pasho, gjatë ushtrimit të tagrave procedurale si drejtues i Prokurorisë apo si prokuror i çështjes për tri procedimet penale të sipërcituara²¹, ka qenë në kushtet e një prej rasteve të përcaktuara në nenet 15, 16 të Kodit të Procedurës Penale, ndaj do të duhet të kishte hequr dorë sipas nenit 17 të po këtij Kodi, si dhe të njoftonte Prokurorin e Përgjithshëm sipas nenit 3, germa “ç” e ligjit nr. 8737/2001.

Për më tepër, pakica çmon të theksojë se për procedimet penale nr. {***} të vitit 2014 dhe nr. {***} të vitit 2015, vendimet e pushimit të miratuara prej subjektit të rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, nuk janë ankimuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë dhe Komisariati i Policisë Gjirokastrë, të cilat kanë qenë organet që kanë bërë referimin e

¹⁸ Shih paragrafët 34 dhe 35 të vendimit të Kolegjit.

¹⁹ Për më shumë, shih citimin e përgjigjes në paragrafin 44 të vendimit të shumicës.

²⁰ Në gusht të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka pasur një marrëdhënie huaje me z. I. M., e cila në kuptim të nenit 5, germa “dh” e ligjit nr. 9367/2005 përfshihet në rrethin e marrëdhënieve të interesit.

²¹ Të cilat i përkasin periudhës maj 2014 - gusht 2015.

materialeve kallëzuese, çfarë nënkupton se ndaj subjektit nuk mund të ketë dyshime se ka pasur një vendimmarrje favorizuese ndaj shtetasit I. M. dhe shoqërive të tij. Në të njëjtën mënyrë janë sjellë këto organe edhe pas vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***}, viti 2015, në të cilin subjekti i rivlerësimit Arben Pasho ka qenë në cilësinë e prokurorit të çështjes.

Bazuar në sa më sipër, pakica vlerëson se sipas akteve të administruara, shpjegimeve dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të konkludohet që në tri procedimet penale ndaj shtetasit I. M., nr. {***} të vitit 2014, nr. {***} të vitit 2015 dhe nr. {***} të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë apo prokurorit të çështjes, duhet të kishte njoftuar Prokurorin e Përgjithshëm për shmangien e konfliktit të interesit. Për rrjedhojë, pakica përfundimisht vlerëson se, përderisa nuk konkludohet për një shkelje etike të subjektit të rivlerësimit Arben Pasho për shkak të konfliktit të interesit, nuk mund të konkludohet edhe për cenim të besimit të publikut të drejtësia sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

III. Mbi zgjidhjen e çështjes

21. Në kushtet kur konkluzionet e Komisionit për kriterin e pasurisë nuk kanë pasur të përcaktuara rastet/shkeljet të cilat merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, pakica vlerëson se në këtë kriter nuk u gjenden shkelje konkrete për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të drejtësia sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Sa u përket shkeljeve në kriterin e aftësive profesionale, pakica edhe pse vlerëson se në këtë kriter nuk u konstatuan shkelje etike të lidhura me konfliktin e interesit, çmon të theksojë se edhe nëse do të ishte provuar konflikti i interesit i subjektit të rivlerësimit Arben Pasho në vendimmarrjet për procedimet penale të z. I. M. apo shoqërive tregtare në të cilat ai është ortak, duke pasur në konsideratë që kualifikimi i shkeljeve sipas përcaktimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, kërkon një vlerësim tërësor të tri kriterëve të rivlerësimit apo vlerësim të përgjithshëm të procedurave të rivlerësimit në raport me sjelljen e subjektit gjatë këtij procesi, vlerësimi i bazuar vetëm në shkeljet e konstatuara në një kriter, pra atë të aftësive profesionale, nuk do të ishte në frymën e ligjit për vlerësimin e cenimit të besimit të publikut të drejtësia.

Në përfundim, pakica, në bazë të autoritetit diskrecional të gjykatës për zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, i konsideroi konkluzionet e Komisionit për kontrollin e kriterit të pasurisë dhe të aftësive profesionale, si të pamjaftueshme për t'u kualifikuar sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Në këto kushte, pakica vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1, gerrat "a", "b" dhe "c" të ligjit nr. 84/2016, duke arritur në një nivel të besueshëm në vlerësimin e të tria kriterëve.

22. Bazuar në sa më sipër, përfundimisht në gjyqtarët në pakicë vlerësuam se, bazuar në nenin 66, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, vendimi i Komisionit nr. 147, datë 16.05.2019, duhej të ndryshohej dhe subjekti i rivlerësimit Arben Pasho të konfirmohej në detyrë.

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi